

Historia eshte e lashte. E vetmja gje e re ne histori jane Shtetet e Bashkuara te Amerikes. Amerika eshte i vetmi vend ne bote qe ka eksportuar liri.

Konsiderate e Fatos Nanos, kryeminister i Shqiperise, dhene shtypit te shkruar pergjate fushates se nderhyrjes ushtarake anglo-amerikane ne Irak.

LUFTA NE IRAK NE FOKUSIN E SHTYPIT DHE TE POLITIKES SHQIPTARE

1. Lufta ne Irak ne vemendjen e shtypit te shkruar shqiptar

Lufta ne Irak ka patur nje jehone te konsiderueshme ne shtypin shqiptar sikurse edhe ne mjetet e tjera te masmedias elektronike te vendit veçanerisht duke filluar nga fundi i rpillit dhe fillimi i marsit 2003. Pasi zuri vendin e pare si lajm dhe si problematike ne kohen e spherthimit te Luftes, kriza irakiane vazhdon edhe me pas te kete nje jehone mediatike te konsiderueshme edhe pas zgjidhjes se saj.

Gjinite e publicistikes se perdorur per te trajtuar krien irakiane kane qene te larmishme. Jehona e Luftes eshte percjelle nepermjet lajmeve mbi zhvillimet politike nderkombetare dhe mbi teatrin e luftimeve ne terren, nepermjet botimit te deklarave dhe qendrimeve politike dhe gjeostrategjike te aktoreve politike nderkombetare, si edhe duke paraqitur analiza lidhur me raportin e forcave ushtarake dhe strategjike midis paleve nderluftuese. Persa i perket burimit te lajmeve, duhet nenvizuar fakti se shtypi i shkruar shqiptar mbetet akoma i varur nga informacionet qe jep shtypi nderkombetar, rrjetet nderkombetare te raditelevizioneve te huaja apo agjencite e huaja telegrafike. Duke mos pasur korrespondentet e vet ne terren, shtypi shqiptar ndjek megjithate me kujdes dhe me vazhdimesi rrjedhen e luftimeve dhe te jetes politike nderkombetare. Ai e ka bere kete hap pas hapi dhe me kujdes te veçante. Po ne kete plan, mund te thuhet se pak a shume publiku shqiptar mbetet shume mire i informuar lidhur me ecurine e ngjarjeve te krizes irakiane. Shtypi shqiptar mbetet jashtezakonisht mire i lidhur ne forme elektronike me burimet kryesore te informacionit nderkombetar. Ne kete drejtim, ai eshte i detyruar te ece ne nje hap me rrjedhen e fenomeneve dhe te ngjarjeve sepse drejtuesit e tij jane te ndergjegjshem se kane te bejne me nje publik qe ndjek drejtpersedrejt informacionet politike te prejardhura nga kanalet televizive dhe radiofonike nderkombetare te kapura gjeresisht ne Shqiperi.

Forma te tjera te gjinive publicistike te perdorura kane qene artikujt problemore, botimi i opinionëve te aktoreve politike dhe shoqerore shqiptare, botimi i mjaft analizave te autoreve te huaj te perkthyer ne shqip, sikurse edhe vizatime, humor

me teme nga lufta, fotografi te ndryshme qe fiksojne pamje domethenese nga teatri i luftimeve etj.

Ne nje pamje te pare mund te krijohet pershtypja se perderisa pozicioni i shtetit shqiptar dhe i forcave politike kryesore te vendit ka qene ne mbeshtetje te nderhyrjes amerikane ne Irak, edhe shtypi dhe mediat shqiptare duhet te kene pasur nje qendrim pak a shume homogjen ne perkrahje te kesaj lufte. Ne fakt, ne nje mase te konsiderueshme keshtu ka ndodhur. Por, ky pohim nuk perfaqeson krejtesisht te gjithe te verteten mbi ate se si eshte pasqyruar lufta ne Irak nepermjet shtypit shqiptar. Nga nje studim i hollesishem i shtypit te shkruar mund te dilet ne perfundimin se ai ka shpalosur, ne fakt, nje sere nuancash, lekundjesh dhe dilemash, ka zhvilluar nje game relativisht te gjere qendrimesh dhe pozicionesh, te cilat e detyrojne analizen te behet me e ndjeshme me qellim qe te mos humbase fillin e asaj qe perben tablone e vertete te realitetit.

Aq me teper duhet mbajtur parasysh fakti se pavaresisht mbivendosjeve te konsiderueshme midis strategjive te aktoreve politike dhe strategjive te aktoreve mediatike (gazetave, botuesve, stacioneve televizive etj.) jane konstatuar edhe taktika dhe qendrimet te ndryshme te ndjekura prej tyre. Ne kete plan nuk mund te thuhet aspak se politika dhe mediat kane mbajtur te njejtin qendrim lidhur me luften ne Irak sikurse mund te flitej ne menyre disi te siperfaqshme.

Situata behet edhe me e nderlikuar po te mbahet parasysh fakti qe, ndofta per here te pare ne historine e shtypit dhe te mediave elektronike te periudhes pakomuniste, ka nje ndryshim metodologjik te theksuar ne peraftrimin qe i behet nje ngjarjeje te caktuar nga ana e politikës dhe nga ana e mediave. Politika shqiptare ne zerin e perfaqesuesve te saj kryesore eshte pa hezitime, te pakten pa hezitime te shprehura publikisht, ne qendrimin qe mban ndaj nderhyrjes anglo-amerikane ne Irak. Ajo rendit argumenta te plote per te perligjur qendrimin e saj ne perkrahje te Luftes. Nderkaq, ne segmente te rendesishem te shtypit shqiptar, krahas nje qendrimi themelor ne perkrahje te nderhyrjes ushtarak ne Irak, paraqiten edhe probleme qe lidhen me pasojat politike dhe ushtarake te kesaj lufte si edhe dilema te ndryshme qe kane te bejne me rendin e sotem nderkombetar dhe parimet ne baze te te cilit ai eshte ndertuar.

Lidhur me analizen e ligjerimit politiko-mediatik rreth luftes ne Irak mund te thuhet se ajo ka vend te perqendrohet ne disa aspekte qe duken si me te rendesishme. Ndrichimi i tyre mund te hedhe drite jo vetem mbi menyren e funksionimit te politikës shqiptare, por edhe mbi marredheniet e medias me politiken, te mediave me shoqerine, etj. Le te shohim, pra, disa syresh.

2. Argumente dhe sisteme gjykimi politik

Argumentat qe jane dhene lidhur me nje qendrim ne perkrahje te Luftes dhe te nderhyrjes ushtarake anglo-amerikane ne Irak perbejne nje sistem te tere aresyetimesh qe i permbahen logjikave politike nga me te ndryshmet. Diku merren per baze argumenta te natyres historike, diku gjetke perdoren kriteret e cilat vendosin ne themel te ndertimit te marredhenieve nderkombetare parime qe

kane te bejne juridikisht vetem me strukturimin e jetes politike te brendshme te shteteve te veçante, diku tjeter merret per baze parimi i perkrahjes se me te fortit ne arenen nderkombetare, ne ndonje rast tjeter argumentat mbeshteten me shume ne konceptimin e nje fare « realpolitike » qe duhet te ndjeke klasa politike shqiptare ne sigurimin e interesave gjeostrategjike kombetare, etj. Pavaresisht se te gjitha argumentat e perpunuar shkojne ne perkrahje te nderhyrjes anglo-amerikane ne Irak, duhet thene se ata nuk legjitimohen ne baze te logjikave politike dhe te modeleve teoriko-juridike te njejte. Aq e dukshme eshte kjo saqe mund te thuhet se ne perpunimin e argumenteve ne perkrahje te nderhyrjes ushtarake ne Irak ka nje koherence te tipit pragmatik. Me fjale te tjera, pranohen dhe perpunohen te gjitha ato argumente qe shkojne ne favor te Luftes, ndonese baza metodologjike dhe teoriko-juridike e tyre mund te jete e ndryshme.

Ne kete kuader mund te thuhet se argumentat e perdorur mbeshteten ne keto sisteme argumentimi :

1. Parimi i zgjerimit te rrethit te shteteve demokratike ne bote qofte edhe nepermjet nderhyrjeve ushtarake dhe imponimit te modelit politik demokratik.
2. Parimi i ndjekjes se « realpolitikes » domethene i mbajtjes ne konsiderate te faktit se cilido qendrim ushtarako-politik ne planin nderkombetar eshte i legjitimuar perderisa ai perputhet me interesat kombetare te nje shteti, ne kete rast te shtetit shqiptar.
3. Parimi i respektimit te faktit te nje bote « nje polare » dhe i rrjeshtimit te Shqiperise ne anen e me te fortit.
4. Parimi i dhenies se perparises se sigurimit te nje rendi te qendrueshem nderkombetar, te mbeshtetur ne kontrollin e tij prej shteteve te fuqishme demokratike (ne rradhe te pare SHBA) duke evituar rreziqet qe mund t'i vijne statukuose se tanishme nderkombetare prej rregjimeve diktatoriale te armatosura eventualisht me arme te shkaterrimit ne mase.
5. Parimi i politikes « me jep te jap » mbeshtetur ne kredon tradicionale te prejardhur nga mentalitete klanike « te shlyerjes se borxhit moral dhe politik. » Perkrahjet ne politiken e jashtme ai shtet, i cili me pare na ka perkrahur per te arritur nje fitore politike ne planin nderkombetar.

Nuk eshte vendi ketu te aresyetojme mbi themeltesine apo pathemeltesine e seicilit nga keto sisteme legjitimimi te politikes dhe te ngjarjeve nderkombetare. Ne rrethet akademike nderkombetare, ne Europe dhe ne Shtetet e Bashkuara te Europes, ka debate te pafund rreth tyre. Ne fakt, seicili prej ketyre sistemeve teoriko-juridike ka koherencat dhe provat e paluejtshme te veteargumentimit sikurse permban edhe mangesi edhe dobesi te natyres argumentuese. Ajo qe na intereson ne kete trajtese eshte fakti se ne rastin shqiptar, te gjitha keto sisteme argumentimi, ne parim divergjente, kane krijuar nje koherence qe shpjegohet teresisht me veçanësitë e konjuktues politike te krijuar ne Shqiperi.

Na duket me interes te themi se ka ndodhur qe i njejti aktor politik te kete perpunuar dhe shprehur argumente ne perkrahje te luftes ne Irak duke u mbeshtetur ne aresyetime politiko-strategjike qe, ne parim, nuk jane te pajtueshme me njera tjetren. Te sqarohemi nje here e mire : behet fjale per sisteme argumentimi, te cilat ne parim mund te jene divergjente me njeri tjetrin, por qe lidhur me rastin konkret te luftes ne Irak, ne konjuktoren konkrete te politikes se sotme shqiptare, keto sisteme argumentimi kane prodhuar nje koherence pak a shume te konsiderueshme per te legjitimuar qendrimin pro luftes te mbajtur nga ana e politikes shqiptare.

Argumentat e botuar ne shtyp ne perkrahje te nderhyrjes ushtarake ne Irak jane te formuluar ne menyre te ndryshme ne varesi te faktit se cili aktor shoqeror dhe politik i ka shprehur ato. Ne kete kuptim mund te thuhet se argumentat e dhena mund te klasifikohen edhe nga pikepamja e referuesit te tyre. Shkurtimeisht, po t'i permbahemi kesaj metode « referenciale » do te mund te thoshin se argumentat proluftes do te ndaheshin si me poshte :

1. Argumenta dhe qendrimet politike te shprehura nga ana e aktoreve kryesore politike. Ato jane pa ekuivok, shprehen ne menyre shume te vendosur, evitojne çfaredolloj hezitimi lidhur me qendrimet politike te mbajtura, formulohen me shume ne forme deklaratash politike, shmangin dikutimet per çfaredolloj kunderargumenti qe do te hidhte edhe hijen me te vogel mbi deklarimet e bera ne mbeshtetje te Luftes, etj.
2. Argumenta dhe qendrimet te mbajtura nga aktore shoqerore te personalizuar, qofshin keta analiste, gazetare, shkrintare, personalitete te kultures, etj. Ne kete rast, qendrimet jane ne pjesen dermuese prnderhyrjes ushtarake te anglo-amerikaneve ne Irak, por gjithesesi menyra e argumentimit te tyre eshte e formes se « bute ». Kjo do te thote se krahas shprehjes se argumentave ne mbeshtetje te Luftes, paraqiten here pas here edhe dilema, kundershiti, mundesi te kunderta qe duhen mbajtur parasysh, hezitime te natyrave nga me te ndryshmet, etj.
3. Qendrimet te mbajtuar nga aktore mediake, te shprehura ne formen e politikave te botimit, te organizimit te hapësirës së botuar, te lejimit te ballafaqimit te pozicioneve te ndryshme ne shtyp, te formulimit te titujve apo nentitujve te dokumenteve te botuara, etj. Ne kete rast, mund te dallohen gazeta qe kane mbajtur nje qendrim me te prere pro luftes, qe kane botuar materiale thujse ekskluzivisht ne mbeshtetje te saj dhe gazeta ku hapësira e botimit ka qene pak a shume e hapur per teza dhe kunderteza, per argumenta dhe kunderargumenta, per qendrimet kryesisht ne mbeshtetje te Luftes, por edhe per nuanca te holla, per dilema disi te fshehura apo per kundershiti te pjeseshme ose te plota ndaj nderhyrjes ushtarake ne Irak.

3. Qendrimet ne perkrahje te Luftes ne shtypin e shkruar

Le te shohim tani me konkretisht disa nga qendrimet me domethenese dhe tipike ne mbeshtetje te nderhyrjes ushtarake ne Irak, te mbajtur nga aktore politike dhe shoqerore te spikatur te jetes politike dhe mediatike shqiptare.

Ne nje interviste qe shkrintari Ismail Kadare i ka dhene kryeredaktorit te gazetes *Shekulli* (7 mars 2003) thekson me perparesi dy argumente qe, sipas tij, shkojne ne te mire te perkrahjes qe politika shqiptare i ka bere nderhyrjes angloamerikane ne Irak. Ai bashkon faktin se Shqiperia e ka per detyre te mbeshtese SHBA (perderisa keto te fundit e kane mbeshtetur tradicionalisht Shqiperine ne perpjekjet per te ruajtur pavaresine dhe integritetin e saj kombetar) me faktin tjetër se, me rolin e vet lidhur me statukuone e tanishme ne Kosove, SHBA mbetet nje aleat per interesat e sotme te shqiptareve. Ne kete interviste Ismail Kadare shprehet : « Mendoj se Shqiperia ka bere nje zgjedhje te drejte. Mirenjohja tradicionale ndaj SHBA, (kundershtimi amerikan per copetimin e Shqiperise ne fillim te shekullit dhe roli kryesor per çlirimin e Kosoves ne fund te tij), per fat te mire nuk bie ndesh me interesat e sotme te shqiptare dhe SHBA mbeten sot aleati yne i fuqishem. »

Me poshte, ne intervisten e tij, Ismail Kadare ndjek nje linje aresyetimi te mbeshtetur ne analogjine. Ai nisat nga parimi i gjykimit te tendencave te sotme ne brendesi te rendit nderkombetar, duke u nisur nga nje logjike lokale. Ai aresyeton lidhur me fatet dhe interesat e kombit shqiptar apo te kombeve te tjere te shtypur nga rregjime etnikisht dhe politikisht diktatoriale. Lufta ne Kosove ishte shpetimtare per kosovaret ne kuptimin qe iu dha atyre lirine prej rregjimit te Milosheviçit. Po keshtu, pavaresisht kundershtimeve te faktoreve te ndryshem nderkombetare, Lufta ne Irak kunder rregjimit te Sadamit, eshte duke iu dhene liri politike masave te gjera te popullit irakian. Duke u mbeshtetur ne kete analogji qe e vlereson ngjarjen nderkombetare nisur nga nje logjike e nivelit lokal, Ismail Kadare pohon se « Nje aresye me teper qe opinioni publik te jete gjeresisht ne favor te nje nderhyrjeje ne Irak eshte kujtimi i drames se Kosoves, atehere kur shqiptaret prisnin me padurim nderhyrjen ushtarake te NATO-s kunder rregjimit te Milosheviçit, aq shume te ngjashem me ate te Sadam Hyseinit sot. »

Ambasadori shqiptar ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, Fatos Tarifa, eshte dalluar nepermjet dy a tre shkrimeve tejet te gjata, te botuara ne shtypin e perditshem te Tiranes, ne te cilat ai zhvillon nje sere argumentash lidhur me domosdoshmerine e rreshtimit te shtetit shqiptar perkrah fuqise amerikane me rastin e nderhyrjes se saj ushtarake ne Irak. Sistemi i marredhenieve te sotme nderkombetare nuk eshte me dypolar sikurse ishte ne periudhen e Luftes se ftohte – thote ai. Por, ky sistem nuk eshte edhe as shumepolar siç mund te jete, eventualisht, ne nje te ardhme te larget. Ne boten e sotme asnje fuqi tjetër, domethene as Europa e Bashkuar, as Kina e as Japonia nuk mund te rivalizojne me fuqine amerikane. Kjo bote njepolare kerkon te mbahet parasysh fakti qe fuqia amerikane perben faktorin vendimtar te stabilitetit te rendit te sotem nderkombetar dhe elementin kryesor per t'u mbajtur parasysh ne marredheniet e sotme politike nderkombetare. Shtetet me te vegjel, per t'u zhvilluar dhe per te garantuar sovranitetin e interesave te tyre kombetare, kane vetem nje zgjedhje te

aresyeshme, ate te gjetjes se aleancave te qendrueshme me partnerin e fuqishem amerikan. Renditja pas me te fortit ne sistemin e marredhenieve te sotme nderkombetare perben nje nga parimet qe duhet te mbahen mire parasysh per t'u orientuar ne ngjarjet e politikes nderkombetare.

Diplomati shqiptar nuk ben nje analize te mbeshtetur ne argumente qe do te provonin drejtesine apo padrejtesine parimore te nje politike te caktuar te jashtme. Ne te kundert, ai thekson se eshte fuqia me e madhe nderkombetare ajo qe perben polin drejt te cilit duhet te orientohet politika e jashtme e vendeve qe i quan shtete te rangut te dyte.

Ne fakt, dy jane tezat kryesore te nje artikulli tejet te gjate qe ai ka botuar ne gazeten *Shekulli* (10 mars). Teza e tij e pare lidhet me faktin se midis fuqise amerikane dhe vendeve te tjera te botes ka nje distance tejet te konsiderueshme, e cila do te vazhdoje te mbetet e tille edhe per nje kohe shume te gjate. Sipas tij « sado te shpejta te jene ritmet e zhvillimit e te fuqizimit ekonomik, politik, ushtarak dhe teknologjik te nje apo disa vendeve te veçanta, hendeku qe i ndan ato nga Shtetet e Bashkuara te Amerikes, edhe sikur te mos thellohet me tej, do te mbetet per shume kohe i konsiderueshem. » Teza e tij e dyte renditet si nje fare perfundimi logjik i tezes se pare. Perderisa faktori amerikan eshte i pakrahasueshem nga pikepamja e fuqise se tij me cilendo fuqi tjeter, atehere ne gjetjen e aleancave nderkombetare nuk mbetet asnje rruge tjeter, veçse rruga e orientimit pas politikes se tij te jashtme dhe strategjive te tija politiko-ushtarake. Ja se si shkruan diplomati shqiptar nga Washingtoni : « Per sa kohe qe sistemi global i marredhenieve nderkombetare mbetet njepolar, pasiguria ne zgjedhjen e partnereve dhe te aleancave eshte me e vogel, siç eshte me i thjeshte edhe kalkulimi i avantazheve apo i rreziqeve potenciale ne politiken e jashtme te çdo vendi. Ne nje konstelacion te tille marredheniesh nderkombetare, fuqite e medha apo shtetet e rangut te dyte duket se kane dy opsione te arsyeshme : e para, te bashkohen ne aleance me superfuqine e vetme, ne kete rast Shtetet e Bashkuara te Amerikes ; e dyta, te mos ndermarrin veprime, te cilat provokojne antagonizmin e saj. »

Siç shihet, me fjale me te shkoqura, ideja e Fatos Tarifes eshte se ne ditet tona politika e jashtme e çdo vendi eshte thjeshtuar sepse tani ne veprimet e çdo subjekti shtetror ne arenen nderkombetare mbeten te mbahen parasysh dy parime thelbesore : a) te behet aleance me fuqine amerikane ; b) te mos provokohet antagonizmi i saj.

Ne fakt, dy lideret kryesore te jetes politike shqiptare, Fatos Nano dhe Sali Berisha, i jane shmangur paraqitjes se perkrahjes se tyre ndaj nderhyrjes anglo-amerikane ne Irak nen prizmin e teorise se nje « bote njepolare ». Kjo nuk do te thote se ata nuk e mbajne parasysh kete fakt madhor te jetes se sotme nderkombetare. Ne jemi duke theksuar vetem faktin se argumentet e tyre ne perkrahje te nderhyrjes ushtarake ne Irak jane vendosur ne nje plan tjeter, pikerisht ne ate te parimesise ideologjike dhe politike te qendrimeve te mbajtura.

Udheheqesi i opozites demokrate Sali Berisha del perpara gazetaeve me daten 12 mars 2003 dhe shpalos deklaraten e tij ne perkrahje te nderhyrjes ushtarake ne Irak. Eshte me vend te ndalemi ne analizen e kesaj deklarate per shkak se ne te

gjejme disa kendveshtrime disi te veçanta. Sali Berisha del teresisht ne perkrahje te nderhyrjes se ardheshme ushtarake ne Irak, por, siç e thekson vete ai, kete e ben « duke e ndjere veten thellesisht europian ». Ai, pra, ben kujdes te shpalose « identitetin » e tij europian pikerisht ne çastin kur eshte duke marre nje qendrim politik qe shkon ne kahun e kundert me orientimin e politikës se jashtme te disa vendeve europiane si pershembell Gjermania, Franca, Belgjika si edhe me nje lloh parapëlqimi te instancave drejtuese te Bashkimit Europian.

Sali Berisha i njej mire kundershite e ketyre vendeve ndaj nderhyrjes ushtarake ne Irak qe po pergatisnin angloamerikanet. Keto kundershiti mbeshteten sidomos tek argumenti se duhet respektuar rendi juridik nderkombetar dhe proçedurat e votimit ne Organizaten e Kombeve te Bashkuara. Jemi pikerisht ne kohen kur Kina, Rusia, Franca, Gjermania etj., po kundershtonin aprovimin e projektrezolutes amerikane per t'a detyruar ushtarakisht Sadam Hyseinin per t'u çarmatosur. Sali Berisha perdor nje argument qe e shmang kuadrin juridik formal te çeshtjes dhe e vendos kete te fundit si nje raport te mirefillte force midis Shteteve te Bashkuara te Amerikes dhe terrorizmit nderkombetar. Ai e trajton nderhyrjen ushtarake amerikane ne Irak si nje pergjigje te drejtperdrejte ndaj nje akti te meparshem dhune te ushtruar mbi sovranitetin dhe lirine e kombit amerikan. Shtetet e Bashkuara te Amerikes kane te drejten legjitime te pergjigjen per t'u kundermbrojtur pa marre mendimin e shteteve te tjera, sepse jane pikerisht ato qe jane sulmuar. Sali Berisha shprehet : « 11 shtatori nuk ishte nje sulm ndaj Shqiperise, Italise apo vendeve te Europes, ai ishte nje sulm ndaj SHBA dhe ato kane te drejten legjitime te bejne perpjekje qe sulme te tilla te mos u vijne. Natyrisht pas Mullait, Sadami eshte me i mundshmi qe te organizoje akte terroriste. »

Autori i kesaj deklarate shprehet per nje lidhje te mundshme midis sulmit terrorist te 11 shtatorit 2001 dhe rregjimit te Sadam Hyseinin qe konsiderohet si nje baze eventuale e terrorizmit nderkombetar. Ne fakt, kjo pike ishte dhe vazhdon te mbetet nder me te diskutuarat ne shtypin boteror te kohes dhe te diteve te mepasme.

Sali Berisha perdor edhe nje argument te nje plani tjetër duke u mbeshtetur ne logjiken e « kompensimit » ose te « shperblimit » te nje perkrahjeje te meparshme me nje perkrahje te mevonshme. Ai thote se « nuk duhet te harrojme kurre se shqiptaret kane nje detyrim te padiskutueshem ndaj SHBA per rolin çlirimtar te tyre ne Kosove, per rolin qe ata luajten per çlirimin e Kosoves. »

Ne deklaraten qe po analizojme, sovraniteti dhe legjitimiteti i pushtetit te nje shteti konsiderohet si i ndervarur prej natyres se rregjimit te tij politik. Nje diktature, perderisa nuk eshte legjitime nga pikepamja e parimeve juridike mbi te cilat mbeshtetet shoqeria demokratike dhe respekti i lirive politike te qytetarit, atehere mund dhe duhet te rrezohet edhe me lufte. Nje shtet qe nuk ka legjitimitet demokratik se brendshmi, nuk ka as sovranitet ne planin nderkombetar. Kjo eshte pikepamja qe mbron lideri demokrat. Sali Berisha deklaroi : « Partia demokratike i konsideron diktaturat si fatkeqesite me te medha kombetare, diktatorët si jo legjitim. Une deklaroj ketu nje here e mire, se si intelektual i nje vendi qe perjetoi diktaturen me te eger ne Europe, duke e ndjere veten thellesisht europian, nuk kam veçse mbeshtetjen per perpjekjen e SHBA dhe qeverive te tjera per rrezimin

sa me te shpejte te Saddam Hyseinit dhe procedimin ne kete vend te zgjedhjeve te lira dhe te ndershme. » Eshte e kuptueshme se ketu kemi te bejme me nje qendrim origjinal ne fushen e se drejtes nderkombetare. Legjitimimi i sovranitetit te nje shteti ne planin e marredhenieve nderkombetare konsiderohet sikur te jete i varur prej natyres se pushtetit qe ushtrohet brenda tij. Kjo pikepamje, sado humaniste dhe demokratike qe te jete, mbetet problematike per t'u zbatuar ne praktike per shkakun se shtetet jo demokratike ose gjysem demokratike ne boten e sotme nuk jane edhe aq pak ne numur. Megjithate, ata konsiderohen si subjekte sovrane ne kuadrin e Organizates se Kombeve te Bashkuara.

Gazeta *Zeri i Popullit* (14 Mars) boton deklaraten e kryetarit te partise socialiste dhe e kryeministrit Fatos Nano me rastin e aprovimit ne Kuvendin e Shqiperise te aktit normativ per te kontribuar materialisht, moralisht dhe ushtarakisht ne kuadrin e nderhyrjes angloamerikane ne Irak. Gazeta e partise socialiste e titullon materialin e botuar qe permban deklaraten e Fatos Nanos : *Nano : Shqiperia ne krye te radhes kunder terrorizmit*. Eshte e qarte se ketu shfaqet nenteksti se angazhimi ne krah te fuqise amerikane perben ne radhe te pare nje shprehje te suksesit te politikës se brendshme te qeverisjes socialiste me ne krye Fatos Nanon. Gazeta e socialisteve ne pushtet kerkon qe me rastin e ngjarjes se madhe qe po pergatitej ne kuadrin e politikës nderkombetare te legjitimoje dhe te beje te besueshme rezultatet e politikës se brendshme te qeverise Nano. Ne fakt, kete qendrim mban edhe vete autori i deklarates. Fatos Nano shprehet si me poshte : « Akti normativ eshte vazhdim logjik i aktivitetit te vendit ne 12 vitet e fundit, por veçanerisht eshte vazhdim logjik dhe fryt i transformimeve te jashtezakonshme qe jane bere ne Shqiperi ne 6 vitet e fundit, sidomos ne strukturat e mbrojtjes, ushterine kombetare, i perafimit dhe krijimit te parametrave dhe elementeve te bashkeveprimit te saj me aleatet e medhenj perendimore, me SHBA dhe strukturat e NATO-s ne menyre te veçante. »

Pasi e konsideron luften kunder rregjimit te Saddam Hyseinit si nje front te luftes kunder terrorizmit nderkombetar, Fatos Nano nuk le pa permendur edhe « hallin » e tij se rreshtimi i Shqiperise ne krah te amerikaneve dhe anglezeve ne nderhyrjen e tyre ushtarake ne Irak do te sjelle « efekte pozitive » per qeverisjen e tij. Ja se si shprehet kryeministri shqiptar : « Mbreme numuri dy i Departamentit amerikan te shtetit, ne takim me ambasadorin e Shqiperise ne Washington eshte shprehur se Shqiperia ka dale tani ne krye te radhes. Ne u a themi kete me fjale dhe do ta provojme me vepra. Per ne angazhimi i perbashket ne goditje ndaj Irakut do te kete shume efekte pozitive ne marredheniet tona dypaleshe dhe jo thjesht ne fushen ushtarake, do te bashkepuojme ne Irak dhe kjo do te influencoje ne marredheniet tona ne drejtime qe as qe mund te imagjinohen tani. »

Jane per t'u theksuar edhe argumentet qe jep gazetari dhe analisti Remzi Lani, drejtor i Institutit shqiptar te medias, lidhur me perkrahjen qe politika shqiptare duhet t'i jepte nderhyrjes ushtarake ne Irak. Remzi Lani e sheh sistemin e marredhenieve te sotme nderkombetare si nje arene ne te cilen shtetet e ndryshme kerkojne te pohojne dhe te mbrojne interesat e tyre. Keto interesa i mbrojne aq mire amerikanet, francezet, ruset, dhe po aq mire duhet t'i mbrojne edhe shqiptaret. Remzi Lani shprehet se : « Permenda interesat, pasi te gjitha vendet pro apo kunder Luftes, nisen dhe veprojne ne perputhje me interesat e tyre. Eshte bere e modes te flitet vetem per interesat amerikane, por harrohen interesat ruse,

gjermane, franceze apo britanike. E them kete sepse shoh nje gjykim bardh e zi te gjerave.»

Vendosja e shtetit shqiptar ne krah te Shteteve te Bashkuara te Amerikes konsiderohet si nje e dhene e natyrshme, e kuptueshme dhe e mirepranuar si pasoje e faktit qe shteti amerikan ka mbrojtur interesat e shqiptareve ne Ballkan. Nje aleance e bere duhet respektuar, asaj i duhet qendruar besnik. Remzi Lani, ne pergjigje te pyetjes qe i drejton gazetari i gazetes *Koha Jone* (20 mars) lidhur me pozicionin e Shqiperise per Luften qe sapo kishte nisur ne Irak, pohon : « Une mendoj se zgjedhja qe ka bere Shqiperia ne anen e SHBA ne kete konflikt, eshte e drejte dhe ne perputhje me interesat kombetare te shqiptareve. » Pa mohuar dilemat dhe pyetjet e shumta qe shtrohen lidhur me Luften ne Irak, Remzi Lani shprehet se, megjithate, ka nje pike orientimi qe mbizoteron gjitheshka : « interesat tona kombetare dhe interesat amerikane jane kompatibel. »

Gazetari Gazmend Kapllani shfaqet hezitues, i lekundur, kur eshte fjala per t'i dhene pergjigje pyetjes nese eshte e mundur ne kohet tona te vendoset me dhune dhe bombardime demokracia ne vendet qe vuajne nga rregjimet diktatoriale. (*Koha Jone*, 07. 04. 2003) Me nje fjale, gazetarin e mundon pyetja : A mundet te vendoset demokracia nen bresherin e bombave ? Gazmend Kapllani pergjigjet : « Po t'i referohemi historise pergjigja eshte « fatkeqesisht po ». E vertetojne rastet e Gjermanise, Japonise dhe akoma me aktual, ai i Serbise. Por problemi moral mbetet i pazgjidhur. Para nje jave isha i ftuar ne nje takim te organizuar nga revista « *Deshmi* » e Amnesty International ne Athine. Nje prej pjesmarresve me pyeti nese do te pranoja te permbysej tirania totalitare e Enver Hoxhes me bomba angloamerikane, si tani ne Irak (vertet si nuk ia kemi bere nje pyetje te tille vetes ne shqiptaret, ne diskutimet e zjarra pro dhe kunder luftes ?). Te them te verteten u gjenda ngushte. « Ne princip po. Dhe nese nje tiran i çmendur si Enver Hoxha perpiqej te perfente bomben atomike, patjeter. » - u pergjigja, duke shkaktuar « shok » dhe « shastisje », por edhe indinjimin e salles. Ata qe ndodheshin ne salle e kishin te veshtire te kuptonin e te ndienin ç' do te thoshte tmerr totalitar, internim, « Spaç », katandisje e atdheut ne nje germadhe te izoluar nga i gjithe planeti. »

Konteksti ne te cilin e shtron pyetjen gazetari, ne fakt, i jep te drejte kur ai zgjedh pergjigjen per pyetjen qe shtron. Per nje te burgosur ne Spaç, nje te nxirosur ne fatin e jetes se tij ne nje internim te thelle, a per njerez te ketyre kategorive shoqerore teresisht te privuara nga lirite dhe gezimet shoqerore, edhe nje bombardim i kryer nepermjet nje fushate ushtarake masive mund te ndermerret per te eliminuar nje diktature. Por, problemi eshte se nje shoqeri diktatoriale perbehet edhe nga shtresa te tjera shoqerore, pergjithesisht kategori te mesme shoqerore, teper masive, te cilat nuk dihet nese do t'a pranonin rrezikun e humbjes se jetes nen bombat e aviacionit te huaj per te fituar lirine. Frika nga vdekja, nga terrori, nga dhuna, frike e natyrshme qe kane njerezit, i bene keta qe te pranojne edhe diktatura te egra mbi shpatullat e tyre, ndofta per gjate gjithe jetes.

Vete gazetari nuk eshte i sigurt kur jep nje pozitive pyetjes se : A mund te pranohet vendosjen e nje demokracie nen predhat e bombave ? Pyetja, qe siç thote ai, i drejton salla eshte « Çfare do te beja une qe isha « pro bombave » nese ato

binin mbi trupat e njerezve te mi te dashur, siç ndodh sot ne Irak ? ». « Nuk e di, - u pergjigja, - ndoshta do te isha penduar, ndoshta jo. »

Ne shtypin shqiptar jane dhene edhe pergjigje kunder idese qe kritikon « hegjemonizmin » amerikan mbi te gjithë planetin tone. Dr Sulejman Abazi, kolonel ne Akademinë e mbrojtjes, boton ne gazeten *Shekulli* (06. 04. 2003) artikullin me titull *Lufta dhe antiamerikanizmi*. Ne te, autori na ve perballe nje dileme te forte. Nga njera ane, shprehet ai, na duhet te pranojme arrogancen dhe hegjemonizmin amerikan, nga ana tjetër, duke i lene vend logjikes se gjeostrategjive rajonale na duhet te pranojme agresione lokale, diktatura ne shtete kombetare, genocid mbi popuj te ndryshem, etj. Pikerisht midis ketyre dy te keqiave na duhet te zgjedhim. Autori na thote se e ka bere zgjedhjen e tij. Sipas tij me mire do te ishte te pranonim hegjemonizmin amerikan. Autori shtron nje pyetje retorike : « Atehere do te pranojme nje « hegjemonizem amerikan » per interesat e dominimit te psikologjise se luftes kunder luftes, apo do te pranojme nje antiamerikanizem ne terren per shkak te « brutalitetit » dhe « arrogances » se amerikaneve per zgjidhjen e çeshtjeve madhore te botes. »

Kolonel Abazi i Akademise se Mbrojtjes se Shqiperise ecen me tej duke eksploruar fusha « e minuara » te se drejtes nderkombetare dhe te formave te bashkepunimit nderkombetar. Sipas tij, çdo projekt i perbashket ne bote kerkon nje autoritarizem te ushtruar nga nje qender politike dhe ushtarake e vetme. Duke zbatuar taktikat dhe strategjite e komandimit ushtarak (sipas artit luftarak qe ai me siguri e njeh mire) ne sferen e marredhenieve nderkombetare, ushtaraku Abazi, me graden kolonel, perfundon duke thene se nese duhet qe luften kunder terrorizmit nderkombetar « t'a bejne se bashku Amerika, Rusia, Kina, Anglia, Franca, Gjermania, sepse jane mundesite, atehere ne kete duhet t'a pershendesim te gjithë. Po ne kete bashkesi shtetesh a duhet te kete hegjemoni ? Nuk mund te realizohet nje mision ne qofte se dikush nuk drejton apo udheheqes. Atehere kush duhet te udheheqe ? » Mendimet e kolonel Abazit, te sjellin ndermend idete e dikurshme te ideologjise staliniste mbi rolin udheheqes te partise, qe mesoheshin ne format e edukimit ne parti te ushtrise.

Redaktori i *Shekullit* nuk e cenzuron aspak ushtarakun Abazi, i cili shkon edhe me tej ne inkursionet e tija gjeopolitike. Sipas tij ka ardhur koha qe « me sulm » te vendoset demokracia ne te gjithë boten. Perfundimi qe mund te nxjerresh nga aresyetimet e tij eshte : Ne arenen nderkombetare duhet hegjemonizem, kurse ne planin kombetar shoqeria ka nevojë per demokraci ! Ai ndofta nuk e mat mire kuptimin e fjaleve qe shkruan. Duke kerkuar vendosjen e demokracise ne bote nepermjet nje « mesymjeje te pergjithshme » ushtarake, ai harron se keshtu bota mund te shtyhet drejt nje kaosi te pafund. Ate qe mendon koloneli S. Abazi i Akademise se Mbrojtjes se Shqiperise sigurisht qe nuk e desherojne dhe nuk e urojne as ushtaraket me « fajkonj » te marines amerikane. Koloneli Abazi nuk ngurron : « Demokracia duhet te perballtet dhe te triumfoje mbi diktaturat si nje here dhe nje here tjetër, si per irakianet, po keshtu edhe per shqiptaret, koreanet, kubanezet e shume te tjere. Pikerisht faktet kane sjelle detyrimisht nevojën e kalimit nga nje politike mbrojtese, e ruajtjes dhe e rivendosjes se nje gjendjeje te pandryshueshme – ne nje politike dinamike te sigurimit, te zhvilluar edhe jashte kufijve kombetare, e cila eshte e prirur te menjanoje rrezikun e situatave – krize etnike, sociale, politike, ekonomike brenda nje shteti apo nje rajoni. »

Fatmiresisht keto shprehje nuk merren seriozisht nga fqinjët tane, sepse përndryshe ata do të tmerroheshin nga politikat mesazhëse të ushtarakut shqiptar që kërkon të sigurojë interesat e kombit edhe përtej kufijve kombëtare.

4. Qendrimet kundër Luftes dhe thirrjet për maturi

Ne shtypin shqiptar, qendrimet në përkrahje të nderhyrjes ushtarake angloamerikane në Irak janë ato që mbizoterojnë. Megjithatë, aty - këtu janë ndjere edhe zëra të veçantë, të cilët janë shprehur kategorikisht kundër Luftes që po përgatitej ose po zhvillohej dhe që kanë bërë thirrje për të qenë me të matur dhe me të kujdesshem në qendrimet që shteti shqiptar ka marrë lidhur me këtë çështje. Përsa i përket këtyre qëndrimeve relativisht kritike, duhet thënë se ato karakterizohen nga dy tipare të shfaqjes së tyre mediatisht.

Tipari i parë ka të bëjë me atë se keto zëra kundërshtues janë zhytur, në fakt, në një oqean mediatisht vlerësimesh pozitive për politiken e jashtme amerikane dhe vendosmerinë e saj për t'ua thyer makinën ushtarake të Sadam Hyseinit.

Tipari i dytë ka të bëjë me faktin se veç disa individëve që u paraqiten si përfaqësues të pacifizmit shqiptar, kundërshtaret e tjerë të Luftes nuk dolën në mbrojtje të ndonjë levizjeje shoqërore ose të ndonjë grupimi politik kolektiv.

Qendrimin më të ashpër kundër Luftes e ka mbajtur në shtyp Fatos T. Lubonja. Ai kritikon në radhë të parë disa formulime të bëra nga kryeministri Fatos Nano në gazetën Boston Globe dhe gjetiu. Atje, Fatos Nano u shpreh, në fakt, se historia është e vjetër, ndërsa e vjetëria gjë e re në histori janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës që kanë prodhuar dhe mbartur lirinë dhe demokracinë në të gjithë botën. Fatos T. Lubonja e konsideron të përcipte qëndrimin politik të kryeministrit, të përligjur me konsiderata politiko-historike, sipas tij, të përgjysmuara. Ai kritikon në radhë të parë pohimin e Fatos Nanos duke thënë se « Para disa ditësh gazetën shqiptare botuan në shqip një artikull të Fatos Nanos botuar në Boston Globe në anglisht ku kryeministri ynë që thotë se « po të mos kishin qenë Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe aleatët e tyre (vini re kryeministri nuk e përmend aleatin e tretë Bashkimin Sovjetik. Shen. F.T.) Evropa do të kishte mbetur në çizmen diktatoriale të Hitlerit dhe të nazistëve për breza të tere. »

Për Fatos T. Lubonjen politika ndërkombëtare e ditës nuk mund të mbështet në konsiderata të thjeshta të këtij lloji. Sipas tij, nderhyrja e armatosur në Irak kompromenton edhe nderhyrjen e meparshme në Kosovë. « Analistët kundër Luftes – shprehët Fatos T. Lubonja – konsiderojnë se nderhyrja në Irak e kompromenton jo vetëm nderhyrjen që u bë në Kosovë, por ajo nuk do të mundesonte me nderhyrje të këtij karakteri, duke provuar se amerikanët nderhyjnë vetëm në ato raste kur kanë interesin e tyre dhe jo për të mbrojtur të drejtat e njeriut. » Në fakt, kjo është një ide që është shprehur edhe në shtypin ndërkombëtar. Ajo kërkon që politika amerikane të mbajë parasysh vetëm kriterin e mbrojtjes dhe garantimit të vlerave humanitare dhe demokratike, jashtë çdo lloji përllëgaritjeje dhe interesimi gjeostrategjik dhe ekonomik. Por, në fakt,

nje kerkese e tille do te ishte teper pretenduese sepse dihet qe ne politike aspekti vleror dhe interesi praktik shkojne sebashku.

Me tej Fatos T. Lubonja mendon se perballimi ushtarak i terrorizmit nderkombetar nuk do t'a ule valen terroriste ne bote, por perkundrazi do t'a beje edhe me te forte duke perforcuar nder te tjera edhe rregjime politike diktatoriale. Fatos T. Lubonja shprehet se « Po ashtu kjo lufte e preventimit te terrorizmit nuk mund te kete si alibi zhdukjen e nje rregjimi diktatorial sepse, ne shkalle me te gjere, ajo do te forcoje, siç ka nisur te forcoje, mjaft rregjime apo politika antidemokratike . Mjafton te kujtosh per kete mbeshitetjen qe i u dha Pakistanit pas 11 shtatorit apo edhe heshtjen ndaj Rusise apo Turqise per çeshtjen çeçene ose kurde. » Hipoteza se « lufta e armatosur kunder terrorizmit do t'a perforcroje terrorizmin nderkombetar » mbetet nje hipoteze abstrakte qe duhet vertetuar empirikisht. Por, gjithesesi nje pyetje mund te shtrohet, se ciles analisti nuk i jep pergjigje : Si mund te luftohet terrorizmi nderkombetar ateher, nese nuk perballohet ushtarakisht ?

Fatos T. Lubonja shprehet kunder Luftes edhe ne intervisten qe jep bashke me Genc Rulin dhe Remzi Lanin tek gazeta *Koha Jone* (20 mars). Ne kete interviste, ai shpalos nje seri argumentash te tjere qe ia vlejne te permenden. Ai shprehet : « Sipas meje zgjedhja me e mire per Shqiperine do te ishte ruajtja e nje profili te ulet ne kete mesele, qe do t'i korrespondonte shume me mire disa gjerave : faktit qe kjo lufte po perceptohet gjithnje e me shume boterisht si nje arrogance ndaj shumices se banoreve te ketij planeti, faktit qe shumica e popullsisë shqiptare eshte kunder luftes, faktit qe nuk kemi ndonje interes t'i bejme karshillek Evropes ne perkrahje te Amerikaneve siç beri Nano me artikullin e botuar ne Boston Globe, por edhe e rendesise se ulet te Shqiperise ne lojen boterore edhe faktit qe me boten myslymane ne pergjithesi, edhe per shkaqe historike, ne kemi patur marredhenie te mira. »

Analisti Fatos T. Lubonja konsideron se shumica e popullsisë se planetit eshte kunder Luftes ne Irak. Mirepo sondazhet e bera ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, ne Angli dhe ne vende te tjera te botes nuk flasin ne favor te kesaj ideje. Aq me teper qe ne shumicen e vendeve te Perendimit, opinioni publik ka qene teper i lekundur dhe ka anuar sa nga njera ane ne tjetren te ballances politike. Aq me shume qe ne Shqiperi, sondazhet e opinionit publik nuk kane patur nje natyre aq serioze dhe te mbeshitetur per te treguar per ate se çka mendojne njerzit. Edhe argumenti i « marredhenieve te mira » te Shqiperise me vendet myslymane mbetet jo fort bindes po te mbahet parasysh fakti qe shume nga vendet me popullsi myslymane, madje edhe shtete arabe fqinje me Irakun, shpesh, jo vetem qe nuk e kundershuan nderhyrjen angloamerikane ne Irak, por edhe ofruan lehtesira ushtarake per te. Persa i perket mobilizimit te popullsisë arabo-myslymane pergjate Luftes, duhet thene se ai ka qene teper i dobet.

Gazetari Frrok Çupi, drejtori i Agjencise Telegrafike Shqiptare, eshte paraqitur ne shtyp rreth problematikes se nderhyrjes ushtarake ne Irak, nepermjet nje gjuhe teresisht alegorike, te terthorte, por qe lejon te nenkuptohen, si gjithmone, mesazhe te shprehura nepermjet nentekstesh te fuqishem.

Ne nje artikull te botuar ne gazeten *Koha Jone* (17 mars), titulluar *Lufta, e semura e pavionit 17*, Frrok Çupi niset nga nje perafrim krejt i pakuptimte dhe i jashtem midis dates qe ishte fiksuar si mbarimi kohor i afatit te ultimatimit amerikan ndaj Sadamit dhe numurit te pavionit psikiatrik ne Spitalin civil te Tiranës. Numuri 17, shkruan Frok Çupi, perafron Luften ne Irak dhe çmendurine. Lufta sipas tij eshte nje gje e çmendur. Nenkuptimi eshte i qarte. Asnje aresyetim, asnje aresye, asnje seri argumentash nuk mjaftojne per te bindur nje njeri normal dhe te aresyshem per dobine e nje lufte. Frrok Çupi shprehet « Sidoqofte, akordimi i fillimit te Luftes me daten 17 eshte nje rastesi, por ne pergjithesi lufta eshte nje çmenduri dhe shkon mjaft mire me kuptimin ne gjuhen shqipe...Lufta e fundit kunder Irakut ka hyre ne boten qytetare te Botes, pikerisht si nje e semure. Ndersa lufterat e medha qe ndane fatet e popujve dhe te shteteve vinin nga nje « çmenduri » kolektive e kombeve dhe e popujve, kjo e tanishmja po vjen kunder vullnetit te popujve. »

Me tej, drejtori i Agjencise Telegrafike Shqiptare nderton perfytyrimin e nje bote kaotike qe po shkon çmendurisht drejt nje paradoksi apokaliptik. Sipas tij « vete qytetaret amerikane po shpenzojne kursimet e tyre per te blere « dhoma » dhe « vila » kunder rrezikut te terrorizmit ; plus rroba e mjete te tjera te kushtueshme. »

Ne te vertete, kundershimitet, hezitimet apo edhe dilemat kundrejt nderhyrjes ushtarake ne Irak mund te klasifikohen ne varesi te intensitetit te shprehjes se tyre. Ne kete kuader mund te behej nje perqasje qe do t'i kategorizonte ato ne kater grupe.

Grupi i pare permbledh ato argumenta kunder luftes ne Irak, te cilat mbesheten ne konsiderata dhe aresyetime te drejtperdrejta qe e çojne mendimin drejt idese se kundershimitit te Luftes.

Grupi i dyte ndertohet prej atyre qendrimeve, te cilat megjithese e perkrahin Luften kunder rregjimit te Sadam Hyseinit, pranojne se problemi i nderhyrjes ushtarake ne Irak mbetet kompleks, me shume te panjohura dhe mund te sjelle rezultate te papritura.

Grupi i trete ka te beje me ato artikuj apo dokumente te botuar ne shtyp, te cilet pa u pozicionuar drejtperdrejt lidhur me çeshtjen e Luftes ne Irak, shpalosin ato ideologji dhe botekuptime pacifiste, te cilat jane te papajtueshme me çfaredo lloj Luftes. Po ketu do te klasifikojme edhe ato artikuj informative ose problemore, te cilet kane kerkuar te hyjne ne nivele edhe me te thella te historise se konfliktit midis SHBA dhe Irakut. Ne mjaft artikuj te botuar sidomos tek gazeta *Shekulli* trajtohen rrenje me te thella te nderhyrjes ushtarake amerikane ne Irak se sa ato te luftes kunder terrorizmit arab, te vendosjes se demokracise ne Irak apo te eliminimit te rrezikut te prodhimit te armeve te çfarosjes ne mase. Ne keta dokumente te botuar flitet per interesat ekonomike te amerikane lidhur me naften irakiane si shkak qendror i vemendjes qe shteti amerikan perqendron ne zonen e Lindjes se Mesme dhe ne Irak.

Po ashtu, trajtohet edhe çeshtja e pergjegjesise amerikane lidhur me armatimin e rregjimit diktatorial te Sadamit. Keshtu, ne nje artikull te botuar nga Mirela

Oktrova tek *Shekulli* (5 mars 2003) me titull « Zig-zaku » politik dhe « ylli » i *Sadamit* tregohet qarte se Sadam Hyseini u armatos ne fillim te viteve '80 nga amerikanet si nje rival dhe perballues i regjimit iranian te Komeinit. Mirela Oktrova duke rindertuar historine e dikurshme shprehet se : «Sadami e ndjeu nga frynte era : ai vendosi ta shfrytezoje situaten per konkretizimin e idealeve baathiste, anuloi marreveshjen kufitare me Iranin me 22 shtator 1980 dhe hyri ne Iranin jugor. SHBA-te u rreshtuan krahe tij. Per Iranin filloi embargoja, per Sadamin era e furnizimit legal me teknologjine perendimore te armatimit. Donald Ramsfeld, atehere i ngarkuari i administrates se presidentit Regan me Lindjen e Mesme, vizitoi me 17 dhjetor 1980 Bagdadin zyrtar. Teme bisedimesh : furnizimi i Irakut me arme dhe teknologji prodhimi te armeve konvencionale. Me 1982, Iraku hiqet edhe zyrtarisht prej listes amerikane te financiereve te terrorizmit. Furnizues te tij nuk jane vetem SHBA-te, por edhe aleatet e tyre perendimore. »

Grupi i katert perfaqesohet nga ato qendrimet, te cilat ndonese shpalosen ne mbeshetje te rrezimit te Sadam Hyseinit, perseri kerkojne qe politika e shtetit shqiptar te jete me e matur, me e permbajtur dhe me e kujdesshme me qellim qe te mos radikalizohet.

Lidhur me kete grupim te katert pikepamjesh, veç idese se Fatos T. Lubonjes per nje « profil te ulet te politikës se jashtme shqiptare lidhur me konfliktin midis SHBA dhe Irakut », kemi konstatuar edhe qendrimet e tjera te ngjashme si per shembull ai Andi Bejtjes te botuar tek revista *Klan* (26 mars).

Ne artikullin e tij *Çfare fitojme nga Lufta*, Andi Bejtja pranon se qeveria shqiptare e kishte te detyruar te mbante nje qendrim ne perkrahje te Luftes ne Irak. Por shkalla e angazhimit mund te kishte qene me e vogel. Sipas Andi Bejtjes, Shqiperia mund te merrte nje qendrim me te heshtur dhe me te bute, gjithesesi ne perkrahje te nderhyrjes ushtarake ne Irak. Kjo, per dy arsye qe ai permend rradhazi : « E para, sepse nje pjese e mire e Europes dhe e Botes eshte kundra kesaj lufte dhe e dyta, aleancat boterore qe do te krijohen pas kesaj lufte jane akoma te paqarta. Ndodhemi perpara atyre momenteve delikate ku askush nuk e ka te sigurte se ne ç'krahe do te levize diplomacia zyrtare por edhe simpatia e opinionit publik nderkombetar, simpati, ne baze te se ciles, fundja fundit do te bazohen edhe politikat e ardhshme. Dhe veçanerisht ne kete lufte, simpatite apo antipatite e popujve do te jene me te rendesishme se rezultati i saj. »

Gjykimi i mesiperem nuk eshte pa nje domethenie te arsyeshme. Sa here qe fillon nje lufte, sado te dihet qe me pare se raporti i forcave ushtarake anon nga njera ane e balances, perseri rezultati i saj nuk mund te dihet qysh ne fillim. Nga kjo pikepamje mund te kete vend per hezitime. Porse ne politike, vendi per te hezituat eshte teper i ngushte. Nje spektator apo nje analist mund te qendroje hezitues dhe te prese per te pare me mire zhvillimin e ngjarjeve. Ndersa, ne politike duhen marre vendime te shpejta, shpesh here qysh ne fillim dhe prerazi sepse kete mund t'a detyrojne rrethanat politike te kohes. Politika eshte risk, ajo nuk mund te hezitoje gjate per te anuar nga njeri apo tjetri krahe i balances se forcave politike. Shpesh, vendimmarrja politike eshte nje proces qe realizohet si nje akt voluntarist pa pritur qe te perllogariten deri ne fund pasojat e akteve te ndermarra.

5. SHBA dhe Europa Perendimore

Shteti shqiptar ndodhet midis Shiles dhe Karibdes, nderkohe qe mundohet te marre nje qendrim lidhur me konfliktin amerikano-irakien. I interesuar per te mbajtur dhe perforcuar aleancen e vet politike dhe ushtarake me SHBA, shteti shqiptar del ne perkrahje te Luftes, lejon te gjitha lehtesirat ne territorin e vet per makinën ushtarake anti-irakiane, vendos te dergoje trupa komando ne zonen e luftes, drejtuesit e tij bejne deklarata te prera ne qendrimet e tyre pro-amerikane. Nderkohe, Shqiperia eshte nje shtet europian. Aq me teper ajo ndodhet ne nje proces transformimesh politike, juridike, shoqerore dhe ekonomike qe kane si qellim integrimin e saj europian. Instancat politike dhe administrative te Bashkimit Europian vezhgojne çdo hap te politikës shqiptare. E nderkohe, disa nga vendet me te fuqishme dhe percaktuese ne politiken e Europes se Bashkuar, Franca dhe Gjermania, kane marre qendrime kunder Luftes.

Te gjithë kete situatë politike, shtypi i shkruar munda t'a nxjerre ne pah ne te tere permasat e veta. Ne mjaft deklarime dhe pohime ne shtyp, politikane, intelektuale, analiste etj. kane shprehur qendrime te ndryshme lidhur me pasojat qe do te kete qendrimi proamerikan i Shqiperise ne kontekstin e perpjekjeve te saja per t'u integruar ne Bashkimin Europian.

Lidhur me kete problem, mund te dallohen disa tipe qendrimesh, te cilet ndryshojne thuajse kryekeput prej njeri tjetrit.

Mbeshtetësit e nje politike ne perkrahje te politikës amerikane kane vene ne dukje se Bashkimi Europian nuk ka perse te ndermarre « masa ndeshkimi » ndaj Shqiperise perderisa vete vendet anetare te tij kane mbajtur qendrime te kunderta lidhur me nderhyrjen e angloamerikaneve ne Irak. Franca, Belgjika dhe Gjermania vertet e kane kundërshtuar kete nderhyrje, por nga ana tjetër shtete te tilla si Italia, Anglia, Spanja etj., jane shpallur mbështetës te nje inisiativë qe do te çonte ne rrezimin me dhune te rregjimit te Saddam Hyseinit. Nga kjo pikepamje, thuhet prej analistëve ne shtyp, perderisa nuk ka nje qendrim unik te Bashkimit Europian, atehere nuk ka edhe perse i kerkohet llogari shteteve si Shqiperia qe kane ushtruar te drejten e tyre sovranë per t'u sjelle ne arenën nderkombetare si subjekte te pavarur. Gazetari Remzi Lani ne intervisten qe kemi cituar, dhene gazetes *Koha Jone*, thekson si me poshte : « Nuk mund te flitet per presion te Bashkimit Europian, pasi ne te vertete nuk ka nje qendrim te Bashkimit Europian rreth krizes. Nuk mendoj se do te ishte e drejte dhe logjike qe te identifikohet Europa vetem me Francën dhe Gjermaninë. Nuk jane me pak Europe, Spanja, Italia, Britania e Madhe, apo edhe Polonia. »

Po ne kete interviste qe iu drejtohet tre aktoreve te jetës politike dhe intelektuale shqiptare, Genc Ruli, ish deputet dhe drejtues i nje OJQ, konsideron se Europa Perendimore nuk ka perse kerkon qe vendet candidate per te hyre ne Bashkimin Europian ose qe aspirojnë te hyjne ne te te mbajne kete apo ate qendrim politik ne arenën politike nderkombetare. E gjitha kjo per faktin e thjeshte se politika e jashtme e Bashkimit Europian nuk ka asnje lloj identiteti kolektiv. Genc Ruli persa me siper shprehet : « Ne planin e principeve dhe te kriterëve, qendrimi unik

i shteteve anetare kandidate apo metonjese te Bashkimit Evropian, ne çeshtje te politikës nderkombetare as ka perbere dhe as ka qene i mundur te behet nje kriter vleresues i nje identiteti kolektiv. Europa e Bashkuar ka deshmuar fatkeqesisht se eshte teper e paafte te jete e bashkuar persa i perket nje politike te jashtme te perbashket. »

Po ne kete kuader, shkrimtari Ismail Kadare kritikon ate qe ai e quan « nervozizem » qe u shfaq ne France lidhur me qendrimin ne perkrahje te politikës amerikane, mbajtur prej disa vendeve lindore te Europës, midis tyre edhe prej Shqiperise. Ismail Kadare thote ne intervisten e cituar, dhene gazetes *Shekulli*, se : « Dihet tashme se zgjedhja qe bene keto vende, e Shqiperia bashke me to, perkrah Evropës Atlantike, shkaktoi nervozizem te perzier me ironi, ne ate qe u quajt « Evrope e vjeter », sidomos ne France. Nervozizmi, e aq me teper ironia jane quajtur fare te pavend nga vete publiku francez. »

Nderkaq, disa analiste te tjere kane shprehur shqetesimin se « inati » i Bashkimit Evropian do te bjere, ne mos sot neser, mbi Shqiperine. Sipas tyre, kjo e dhene duhet mbajtur mire parasysh sepse mund te sjelle pasoja jo te pelqyeshme politike dhe ekonomike per Shqiperine. Mbajtja dhe perforcim me çdo kusht e nje aleance politike dhe gjeostrategjike me amerikanet persa i perket luftes ne Irak do te kete « faturen » a saj ne marredheniet ekonomike dhe ne investimet europiane ne Shqiperi. Per t'a zbutur kete konflikt, jepen mjaft rekomandime nepermjet shtypit te shkruar. Gjithesesi shenjat e nje presioni evropian ndjehen nga ana e shtypit. Raporti i Bashkimit Evropian mbi ecurine e reformave ne Shqiperi ishte nder me kritiket. Nga ana tjetere, Parlamenti evropian i kerkon Kuvendit shqiptar te mos ratifikoje marreveshjen e nenshkruar ne Tirane midis Fatos Nanos dhe Kolin Pauellit lidhur me mosdorezimit e krimineleve te luftes me kombesi amerikane gjykates penale nderkombetare. Duket se politika shqiptare ndodhet dhe do te ndodhet edhe me shume ne te ardhmen midis dares amerikano – europiane. Gjeopolitika perkrah amerikaneve dhe ekonomia perkrah evropianoperendimoreve – kjo dyfishesi qendrimi politik siç duket do te krijoje probleme serioze per nje kohe te gjate ne fusha te ndryshme te ecurise se politikës shqiptare.

Gazetari Fatos Çoçoli, ne artikullin e tij te titulluar *Mes Shiles dhe Karibdes*, eshte gati i sigurt se trysnia europiane nuk do te vonoje te ndihet mbi politiken shqiptare. Per t'a perballuar ai rekomandon nje angazhim me te madh te shtetit shqiptar ne rrugen e reformave me qellim per t'iu pergjigjur sa me mire kerkesave europiane. Logjika e gazetarit ne fjale eshte mjaft interesante ne kuptimin se ai duket se shpalos nje taktike qe mund t'a ndjekin edhe vete pushtetaret shqiptare. Keta te fundit ka mundesi qe te veprojne me etapa. Ne fillim te zgjidhin problemin e marredhenieve me SHBA duke u vene perkrah tyre ne nderhyrjen ushtarake kunder Irakut. Pastaj, pak nga pak, shpresohet se « gjakrat do te ftohen », qendrimi shqiptar do te harrohet, dhe klima politike do te qetesohet duke i dhene me shume hapësire Shqiperise ne kuadrin evropian. Deri ne ate çast, gazetari shprehet se i a vlen qe te marrim me seriozitet dhe te presim « kokeulur » çdo kritike te ardhur nga instancat e Bashkimit Evropian. Fatos Çoçoli e shpreh keshtu mendimin e tij : « Autoritetet shqiptare, strukturat tona negociuese duhet te tregohen veçanerisht te kujdesshme. Edhe nese vihet re nje ftohje apo nje ashpersim i lehte i qendrimit te eksperteve (ndonese ata jane shume profesionale

per t'a lene te duket kjo gje), ia vlen te tregohemi sikur nuk ka ndodhur asgje, madje te shtojme perkushtimin, angazhimin dhe seriozitetin tone. Ky qendrim i disa europianoperendimoreve (ne rast se do te vertetohet) eshte kalimtar dhe me shperthimin e luftes, nuancat e ftohjes do te harrohen. »

Shpresa e klases politike dhe intelektuale shqiptare qe ka perkrahur nderhyrjen ushtarake angloamerikane ne Irak eshte se Europa Perendimore dhe Shtetet e Bashkuara te Amerikes nje dite do te merren me mire vesh me njeri tjetrin. Permbi dasite e tanishme dhe konfliktet e pjesshme, sipas tyre, keto dy grupime politike e ekonomike ruajne nje unitet te brendshem qe eshte ai i Perendimit ne pergjithesi. Isamil Kadare shprehet si me poshte lidhur me kete ceshtje ne intervisten qe kemi cituar, dhene gazetes *Shekulli* : « Proamerikanizmi yne per ne s'mund te jete kurre ne thelb antieuropian. Mendoj se ky vizion, si te thuash i jashtem per boten perendimore, eshte me i sakti nga te tjeret. Per ne, qe kemi qene te veçuar nga qyteterimi perendimor, Evropa dhe SHBA kane qene nje dhe te pandare. SHBA dhe Evropa jo veç e veç, por bashkarisht, perbenin Perendimin, shpresen tone te vetme per liri. Prandaj acarimi brenda Perendimit nuk mund te perjetohet prej ketyre popujve veçse si nje ngjarje tejet dramatike, qe bie ndesh me interesat e tyre themelore. Ne keto kushte, te gjitha vendet ish komuniste, duke perfshire edhe vendin tone, jane te interesuara qe konflikti SHBA – Evrope te kapercehet dhe uniteti i Perendimit te vendoset sa me shpejt. »

Nderkaq, eshte e kuptueshme qe kundershuesit e Luftes ne Irak te shprehen se « karshilleku » i treguar ndaj Europes do te kete pasoja shume te renda mbi politiken shqiptare. Ne intervisten e cituar, dhene gazetes *Koha Jone*, Fatos T. Lubonja deklaroi se politika shqiptare ka tashme, per fajin e saj, nje perfytyrim shume te keq ne Evrope. Qendrimi i saj i fundit nuk ben veçse e perkeqeson edhe me shume ate. Fatos T. Lubonja shprehet konkretisht se : « Si me kete akt, si pa kete akt, problemi yne kryesor mbetet ai qe politika dhe politikanet tane kane kredibilitetin minimal ne Evrope dhe ne bote per shkaqe qe kane te bejne me menyren se si e menaxhojne brenda kete vend, per lidhjet e tyre me krimin. Ky akt diletantesk, delirant dhe provincial (te tre keto epitete mund te marrin kontekstin ne fjale si sinonime) nuk ben tjetër, veçse e perforcon kete konceptim ne syte e botes. »

6. Lufta ne Irak dhe jeta e brendshme politike ne Shqiperi

Ne shtypin e shkruar dhe ne qendrimet politike te mbajtura prej grupimeve politike kryesore apo prej drejtuesve te tyre bie ne sy fakti se ceshtja e pohimit te nje qendrimi perkrah SHBA eshte nje « molle sherri » midis aktoreve te jetes politike shqiptare. Gjitheseicili kerkon te pohoje qendrimin e tij proamerikan, ne perkrahje te luftes ne Irak, ne mbeshtetje te nderhyrjes ushtarake angloamerikane kunder rregjimit te Sadam Hysein. Ne deklaratat e gjitheseicilit ndihen perpjekjet per te dhene argumenta edhe me te avancuara, edhe me solide se ato te perpunuara nga te tjeret, me qellim qe te perligjet qendrimi perkrah SHBA. Po keshtu, behen perpjekje te etheshme propagandistike qe rivalet politike te paraqiten si antiamerikane, apo proamerikane te pasinqerte, si hipokrite, te cilet politiken proamerikane e kane zbatuar sa per te siguruar nje mbeshtetje nga fuqia

e madhe nderkombetare, per te marre qe andej sigurira politike apo mbeshtetje ekonomike.

Ne kete konflikt te madh, proamerikanizmi, dhe per pasoje, sigurimi i nje mbeshtetjeje amerikane, konsiderohet si nje lloj garancie e kapitalit politik nderkombetar te çdo force politike vendase dhe e mbeshtetjes amerikane qe ajo pretendon se ka ne jeten e brendshme politike te vendit. Edhe kryeministri shqiptar ne te gjitha deklarat e tij te bera ne shtyp, apo ne Kuvend, nuk rresht se pohuari se politika e jashtme e qeverise se tij do te kompensohet nga nje mbeshtetje e gjithaneshme amerikane, do te hape mundesi te reja zhvillimi per shoqerine shqiptare, do te lehtësoje integrimin perendimor te Shqiperise. Nga ana tjetër, « zgjatjen e dores » amerikane drejt Shqiperise, per t'a ftuar ate drejt nje bashkepunimi ushtarak dhe politik, kryeministri shqiptar e paraqet gjithmone ne driten e faktit se kjo ftese per bashkepunim vjen si pasoje e transformimeve te thella pozitive qe jane bere nen drejtimin e qeverise se tij ne Shqiperi.

Gjithesesi çeshtja eshte e qarte. Konflikti i brendshem politik ne Shqiperi ben qe seicila pale politike t'i avancoje gjithnje e me shume qendrimet e veta politike proamerikane dhe t'iu largohet kerkesave per neutralitet apo per rezistence ndaj luftes qe vijne nga vende te Bashkimit Europian, hezitues ose kritikues te nderhyrjes ushtarake te angloamerikane ne Irak. Konflikti i brendshem politik ne Shqiperi, pastabiliteti i seiciles force politike marre ne veçanti, nderluftimi i mprehte politik brenda partise socialiste qe qeveris vendin e qe shprehet ne rivalitetin midis Fatos Nanos dhe Ilir Metes, afrimi i nje periudhe te tensionuar politike qe karakterizon periudhen parazgjedhore lidhur me rinovimin e instancave te pushtetit lokal, paaftesia e forcave politike per te perpunuar nje program te qarte politik per reformat ne Shqiperi dhe nje meri e heshtur e opinionit publik shqiptar ndaj politikave te qeverisjes apo ndaj politikës ne pergjithesi, te gjithe keta faktore kane bere, paradoksalisht, qe seicili nga faktoret kryesore politike te jetes se vendit te marre qendrimet proamerikane gjithnje e me radikale.

Paradoksalisht, ashpersimi i konfliktit politik ne vend, thellimi i krizes ekonomike, destabiliteti i brendshem i cilesdo force politike perben nje nga mekanizmat kryesore te orientimit gjithnje e me koherent te politikës shqiptare drejt politit amerikan. Sa me e dobet te ndihet politika shqiptare ne planin e brendshem, sa me e kercenuar te ndihet nje force politike nga rivalet e saja, aq me shume ajo kerkon t'a kompensoje dobesine e saj te brendshme duke u munduar te gjeje nje mbeshtetje politike te forte nga ana e shtetit amerikan.

Disa gazeta qe kohet e fundit, per aresye qe lidhen me konjuktoren e brendshme politike te vendit, mbajne qendrimet teper kritike ndaj qeverise se Fatos Nanos, nuk kane pushuar se transmetuari ne publik idene se kryeministri shqiptar loz karten e amerikanizmit te thekur dhe ekstremist, ne dem te interesave europiane te Shqiperise, me qellim qe te siguroje mbeshtetjen amerikane ose te paktën tolerimin amerikan lidhur me politiken e tij te brendshme. Karta amerikane do te konsiderohet si nje mbulesë e dobesive te qeverisjes, si nje mburoje e korracuar ndaj kritikave te hidhura te ardhura nga ana e opinioit publik te vendit, si nje kunderpeshe e kritikave teper te renda te adresuara ndaj qeverisjes shqiptare prej Bashkimit Europian, si nje « larje » e vjedhjeve, e korrupsionit, e trafikut te

parave apo te mallrave kontrabande, dukuri keto qe nuk jane te huaja per realitetin shqiptar.

Andi Bejtja ne revisten *Klan* (26.03.2003) shprehet se Shqiperia e kishte per detyre qe te rreshtohet perkrah Shteteve te Bashkuara te Amerikes ne rastin e krizes irakiane. Por, siç thote, gazetari, ka rreshtim e rreshtim. « Edhe rreshtimi ka gradet e tij. » Sipas Andi Bejtjes, deklaratat teper entuziaste te qeverise shqiptare, te mbushura me konsiderata historike dhe me nuanca zhvleresimi per kontributin demokratike te asaj qe u quajt « Evropa e Vjeter », nuk i sherbejne krijimit te nje klime te mire lidhur me procesin e perafimit europian te Shqiperise. Por, notat e deklarimeve zyrtare kane edhe ato nje qellim, i sherbejne kryeministrit Fatos Nano per te mbeshtetur ne keto qendrimet politike karrieren e tij teper te lekundur dhe postin e tij teper te diskutuar te kryeministrit dhe te kryetarit te partis socialiste. Andi Bejtja shprehet se : « I vetmi qe di se çfare ka perfituar nga ky rreshtim kaq i forte dhe i hapur pro luftes ne Irak eshte kryeministri i vendit Fatos Nano, i cili nepermjet nje artikulli dhe dy deklaratave patetike pro amerikane arriti te zhblllokoje ne heshtje nje marreveshje te Fondit Monetar Nderkombetar me Shqiperise dhe te sfumojte shume kritika europiane, qofte edhe vete amerikane per qeverisjen. Keshtu nuk eshte çudi qe proeuropianisti i njohur Fatos Nano, nepermjet nje deklarate ne forme hartimi, arriti te formulonte disa fjali te pazakonshme per te ku Amerika dilte me e mire se vete Zoti. Per Nanon e dime çfare ka perfituar, per vete jo. »

Ndersa vendet e tjera, si Turqia, Maqedonia, vendet arabe fqinje me Irakun, etj., kane ditur te shkembjne qendrimet e tyre ne perkrahje te Amerikes me kontribute te ndryshme amerikane : investime, privilegje tregtare, ndihma ekonomike, investime, etj., Shqiperia dhe klasa e saj politike i jep perkrahjet e veta politike « falas ». Ajo nuk di te rezistojte, te peshojte, te negocioje, te perfitoje nga rrethanat qe krijohen, te jete, me nje fjale, nje partner i denje ne lojen politike nderkombetare. Ajo sillet e perulur duke pritur çfare t'i japin. Gazetari shprehet lidhur me sa me siper : « Ajo qe vlen te nenvizohet pas ketij rreshtimi euforik, ashtu sikurse ne çdo rreshtim politik te Shqiperise ne gjithë kete dhjetvjeçar, Tirana zyrtare nuk di te perfitoje asgje, ashtu sikurse nuk ka ditur asnjehere te negocioje ne kete drejtim. Shqiperia mbajti barren kryesore te luftes ne Kosove ne vitin 1999, ku mbi 700 000 refugjate u dynden ne vendin me te varfer te Europes dhe nderkohe, Maqedonia, ku mberriten 10 here me pak refugjate, per trajtimin e te cileve pati shume kritika nga organizatat e te drejtave te njeriut, perfitoi shume here me shume jo vetem politikisht por edhe ekonomikisht. » Ndonese ne parim verejtja e gazetarit na duket teper e drejte, ne rastin konkret problemi duhet te shihet, ndoshta ne nje plan me te gjere. Ne rastin e nderhyrjes ushtarake ne Kosove, ata qe fituan me shume ne rrafshin e çeshtjes se tyre kombetare ishin pikerisht shqiptaret, jo vetem ata te Kosoves, por edhe ata te Shqiperise dhe te gjithë Ballkanit. Ndersa ishte e kuptueshme qe Maqedonia te shperblehej materialisht per kontributin e dhene lidhur me problemin humanitar te nderhyrjes ne Kosove, Shqiperia, veç anes materiale, perfitonte edhe nje ndihmese te jashtezakonshme ne planin kombetar, politik dhe shoqeror.

Partia dhe socialiste dhe Partia demokratike, nepermjet te dy gazetave perkatese, duke shprehur amerikanizmin e tyre patetik, kane luajtur edhe ne nje plan tjeter. Ato jane munduar qe te akuzohen reciprokisht si hipokrite dhe te

pasinqerta ne qendrimin ne perkrahje te politikes amerikane lidhur me Irakun. Gazeta e Partise socialiste *Zeri i Popullit*, e njohur per kthesat e veta te paprincipia politike dhe ideologjike qysh nga koha kur nuk ishte vecse nje vegjel propagandistike e diktatures totalitare ne Shqiperi, nga antiamerikanizmi i thekur i viteve 1991 – 1996, ka dale ne nje rol paresor ne perkrahje te politikes nderkombetare amerikane. Eshte e veshtire te kuptohet nese qendrimet e tilla radikale apo kthesat e forta rrenjesore e marramendese, ne planin e bindjeve politike, jane ose jo te bazuara ne bindje dhe koncepte te qendrueshme filozofike dhe ideologjike.

Nepermjet nje sere artikujsh propagandistike, organi i Partise socialiste akuzon si antiamerikane te gjitha ata qe nuk jane po aq te zjarrte sa ajo ne mbeshtetje te nderhyrjes ushtarake amerikane ne Irak. Lidhur me deklaraten prolufte qe beri Sali Berisha, gazeta *Zeri i Popullit* (25.03.2003) shprehet se : « PD dhe lideri i saj nuk mbajten per disa jave asnje qendrim, ose mbajten pozicionin « prit e shiko » ne debatin e madh per temen e angazhimit ne kete lufte. Per pasoje lideri i PD-se doli ne skene disi i vonuar, sepse e pa qarte qe edhe ne opinionin e brenshem e te jashtem rezervat e tij personale lidhur me angazhimin e qeverise Nano per kete lufte po beheshin te padobishme per partine demokratike. »

Antiamerikanizmi i kundershhtarit zbulohet edhe lidhur me simbolet me te thjeshta dhe me te parendesishme. Ne artikullin gjithmone pa autor *Nga buron antiamerikanizmi i Berishes*, botuar ne gazeten e Partise socialiste (25. 03. 2003) thuhet : « Sali Berisha beri dje nje hap te papare ne te kaluaren politike te tij, duke urdheruar qe ne te gjitha sheshin Skenderbej, ku u zhvillua mitingu i 11 vjetorit te ardhjes ne pushtet te partise qe drejton, te mos kishte asnje, e theksojme asnje, flamuar amerikan, simbolin e ketij vendi kampion te demokracise, aleatit tone te madh. Ne vazhden e ketij qendrimi te hapur antiamerikan, ai nuk ngurroi t'a mbylle fjalimin e tij te perçartur ne kete miting me thirrjet per Europen, duke injoruar haptazi SHBA. » (Vini re terminologjine e *Zerit te Popullit* kur flet per « aleatin tone te madh », e cila ngjan si dy pika uji me terminologjine e perdorur ne gjysmen e dyte te viteve '40 te shekullit te kaluar lidhur me Jugosllavine e Titos, ne vitet '50 per Bashkimin Sovjetik te Stalinit dhe ne vitet '70 per Kinen e Mao Ce Dunit).

Partite politike kryesore te vendit ndodhen ne nje rivalitet te papare per çeshtjen e raporteve te brendshme shoqerore te jetes se vendit. Qendrimi i tyre ndaj Luftes eshte nje rjedhoje e qendrimet qe ato kane ne fushen politike kombetare. Duke vezhguar dhe kontrolluar antiamerikanizmin e njera tjetres, ato, pa asnje shtyese nga jashte, pa patur nevoje per te kerkuar ndihma, subvencione ose kushtezime te tjera, ato jane futur ne kuadrin e nje logjike te radikalizimit te skajshem lidhur me qendrimet e tyre nderkombetare. Gazetat e te dy partive, te ndodhura brenda nje kuadri mediatiko-politik te tille as nuk behet fjale qe te botojne ne faqet e tyre shkrime analitike ku te merren ne shqyrtim aspektet e ndryshme te ngjarjes se madhe nderkombetare.

Ne kete plan eshte interesante te theksohet se konflikti Amerike – Irak shihet ne prizmin e konfliktit PS – PD. Ne kete marredhenie konfliktuale te dyfishte nuk dihet se cila shtrese ka perparesi ndaj tjetres.

Te dy partite politike rivale i kujtojnë njera tjetres fakte që perbejnë hije në qendrimin e tyre pro amerikan. Partia socialiste nuk rresht se kujtuari faktin se në vitin 1997, administrata shtetërore e qeverisë së partisë demokratike mori qendrimin shpesh herë të hapura anti-amerikane. Nderkohe, Sali Berisha i u kujton socialistëve periudhën kur këta të fundit, në gjysmën e parë të viteve '90 nuk shquheshin për ndjenjën të zjarrta pro amerikane. Duke kujtuar historinë, Sali Berisha i kujton Fatos Nanos aktin e nënshkrimit prej tij të deklarimit me PASOK-un në Athinë, në vitin 1993, ku figuron edhe shprehja që Ballkani t'iu takojë ballkanasve, qendrim që në atë kohë u konsiderua si një ndalesë që i vihej politikës amerikane (një faktor politik jashtballkanik) për të ndikuar mbi fatet e popujve ballkanike. Kjo politike e Partisë Socialiste u konsiderua në atë kohë jo vetëm si anti-amerikane, por edhe si në dem të çështjes kombëtare të shqiptarëve në Ballkan. Në deklaratën e tij, Sali Berisha nuk harron të shtojë se Fatos Nanos « i është dashur të grise deklaratën që ai ka nënshkruar dhjetë vjetë më parë me Papandreun, e cila, siç dihet, ishte në thelb një deklaratë fund e krye antiperendimore, anti-amerikane. »

7. Pamja mediatike e qendrimeve politike rreth luftes në Irak

Pavaresisht se shtypi i shkruar shqiptar është relativisht shumë i politizuar, duhet thënë se lidhur me nderhyrjen ushtarake dhe luftën në Irak, krahas percjelljes së jehonës politike rreth ngjarjeve dhe qendrime të mbajtura, gazetave e perdritshme kanë pasur edhe një lloj autonomie nga politika. Pra, nuk mund të barazohet qendrimi politik i mbajtur nga autoritetet shtetërore të vendit dhe nga partitë politike me atë që ka bërë shtypi i shkruar dhe mediat e tjera. Mediat nuk realizojnë një pasqyrim të thjeshtë të raporteve dhe të varesive politike të vendit, por janë gjithashtu edhe një aktor aktiv, që ka vendin dhe kontributin e vet në krijimin dhe informimin e opinionit publik shqiptar.

Në pamje të parë duket sikur qendrimet ndaj luftes në Irak percaktohen vetëm nga personaliteti, qendrimet politike dhe bindjet ideologjike të artikullshkruesve, të gazetareve apo analistëve të ndryshëm. Duke, pra, sipërfaqshëm, se në shtyp nuk ka veçse qendrimet personale të autoreve të ndryshëm dhe qendrimet kolektive partiake të shprehura nga drejtuesit e partive të ndryshme. Por, në fakt, e verteta nuk është kështu. Pavaresisht se të gjitha gazetave, ose shumica e tyre, ndër me kryesoret, janë shprehur dhe kanë ndjekur një politike botimi që në fakt e ka mbështetur nderhyrjen ushtarake dhe politikën amerikane në Irak, perseri, midis tyre ka nuanca të cilat nuk mund të fshihen. Duket, pra, se politikën editoriale frymëzohen nga logjika e tregut dhe e komercializimit të sensacionit politik, nga lidhjet politike dhe shoqërore të drejtuesve të gazetave me qarqet politike brenda vendit dhe ato diplomatike të akredituara në Shqipëri, nga lidhjet me qeverinë dhe administratën të pronarëve të gazetave të ndryshme, etj.

Në përgjithësi duhet thënë se dy gazetave kryesore politike të vendit të lidhura me Partinë socialiste dhe Partinë demokratike, respektivisht *Zeri i Popullit dhe Rilindja Demokratike*, pavaresisht se i perkasin dy partive politike rivale, kanë thuar se të njëjtin qendrim ndaj nderhyrjes ushtarake amerikane në Irak. E veçanta në qendrimet e tyre është se ato janë thuar se të vetmet gazeta që

sulmojne njera tjetren lidhur me ate se cila prej tyre eshte me shume apo me pak pro amerikane. Eshte e veshtire te gjesh ne to analiza te thella e komplekse lidhur me luften dhe marredheniet nderkombetare te ndertuara perreth saj, apo te gjesh te botuar zera qe kundershtojne luften. Siç e kemi thene, kjo shpjegohet prej faktit se ne kete rast, gazeta rivale do te tregonte me « gisht » kundershhtaren e vet duke e akuzuar per antiamerikane. Eshte e kuptueshme se nga kjo del qe kontrolli politik i partive perkatese mbi shtypin e tyre ka qene dhe vazhdon te jete tejet i konsiderueshem.

Te dyja gazetate jo vetem qe e percjellin politiken, por edhe krijojne ato qe do t'i quanim « artefakte politiko-mediatike ». Me kete term te fundit do te kuptonim qe shtypi i shkruar krijon ne menyre iluzore marredhenie politike te paqena ose jo te permasave reale, per t'i bere ato te besueshme per publikun. Ndonese keta « artefakte politiko-mediatike » mund te mos kene asnje gje te vertete, ndonese ato mund te jene vetem realitete te krijuara virtualisht nga media, perseri, duke i u komunikuar publikut, keto te dhena mediatike luajne nje rol politik teper real.

Nga kjo pikepamje gazeta *Rilindja Demokratike* dhe gazeta *Tema* bejne nje politike botimi, vendosin tituj, apo japin lajme qe te ndikojne mbi lexuesin ne menyre qe ky i fundit te besojte se masa e anetareve te partise socialiste dhe elektorati i saj, te edukuar tradicionalisht me qendrime antiamerikane, ne fakt, nuk e perkrahin nderhyrjen ushtarake ne Irak. Qendrimi pro Luftes konsiderohet se karakterizon vetem nje shtrese te holle, elitare, te klases drejtuese te partise socialiste, e cila per arsye krejt pragmatike mban nje qendrim proamerikan. Po keshtu, te njejte gazeta, lene te nenkuptohet se ne udheheqjen e partise socialiste ka dallime dhe kundershiti lidhur me qendrimin ndaj nderhyrjes ushtarake ne Irak. Lihet te nenkuptohet se brenda hierarkise se larte politike socialiste ka pro amerikane te singerte, siç mund te jene ministri i jashtem Ilir Meta dhe ministri i mbrojtjes Pandeli Majko, dhe hipokrite si Fatos Nano, qe tjetere mendon e tjetere deklarone ne shtyp.

Por, te njejten gje bejne edhe disa gazeta te tjera te quajtura te pavarura, por qe jane relativisht prane partise ne pushtet ose segmenteve te caktuara te saj. Keto gazeta botojne lajme me tituj qe lene te nenkuptohet ideja se edhe brenda rradheve te elites se partise demokratike ka konflikte dhe dallime lidhur me qendrimin qe duhet mbajtur ndaj nderhyrjes ushtarake ne Irak. Keshtu supozohet qysh ne tituj se nenkryetari i partise demokratike, Bamir Topi, eshte me proamerikan se Berisha dhe nuk rresht se kritikuari qendrimin hezitues te prorit te tij partiak.

Duke theksuar kete aspekt, nuk marrim persiper as te konfirmojme as te rrezojme vertetesine e ketyre « artefakteve politiko-mediatike ». Ajo qe desherojme te themi eshte se duke kerkuar pas disa titujve, te ndertuar ne forme pohimesh sensacionale, argumenta ose fakte qe do t'i provonin ato, nuk kemi mundur t'i gjeme aspak. Nga pikepamja e teorise se gazetarise, ato mbeten te paprovuara, pra mediatikisht te paqena. Kjo nuk do te thote megjithate se ato mund te mos jene te vertete, qofte edhe pjeserisht.

Edhe gazeta *Koha Jone* ka nje politike te veten botimi qe i jep tonin qendrimave qe mbahen prej saj ne formen e shenimeve redaksionale apo te kryeartikujve anonime. Nisur nga marredheniet tejet te nderlikuara midis pronarit dhe botuesit te saj dhe kryeministrit Fatos Nano, politika e saj e botimit lidhur me krizen irakiane eshte disi me e veçante. Gazeta pohon katerciperisht se qendrimi proamerikan i shtetit shqiptar eshte diçka e natyrshme qe nuk ka vend te diskutohet. Ai perputhet, ne fakt, me interesat e shqiptareve dhe te stabilitetit dhe te paqes ne bote. Lidhur mbi kete çeshtje gazeta eshte e prere dhe e vendosur. Mirepo, nga ana tjetere, ajo ve ne dukje se kryeministri Fatos Nano eshte duke perfituar ne menyre ta paskrupullt politikisht nga rreshtimi i tij proamerikan. Keto dy elemente gazeta i ndan fare qarte dhe prere. Tjetere eshte fakti i domosdoshmerise se mbeshtetjes se politikës amerikane dhe tjetere spekulimi me kete mbeshtetje per te perforcuar ne menyre te padrejte themelet politike te nje qeverisjeje qe le shume per te dëshruar. Aq me shume, qe sipas gazetes, Fatos Nano perpiqet qe ne kete çeshtje te nxjerre sa me shume perfiime edhe personale duke perforcuar pushtetin e tij si edhe duke fshehur indiferencen dhe paaftesine qeveritare ne perpjekjet qe ajo duhet te beje kunder trafikëve, korrupsionit, krimit te organizuar, etj.

Gazeta *Shekulli* e ka mbuluar fushaten e nderhyrjes ushtarake ne Irak sipas menyres se saj te veçante. Ketu, na duket se kane ndikuar te pakten dy rrethana te ndryshme. Se pari, botuesi i gazetes dhe pronari i saj, sipermarres aktiv ne fushen ekonomike, ka interesa per te qene ne marredhenie sa me te mira me qeverine dhe personalisht me kryeministrin Fatos Nano. Por, ketu problemi duket se nderlikohet. Kjo ndodh per arsye se ne rivalitetin midis kryeministrit Fatos Nano dhe ministrit te jashtem Ilir Meta, çdo ure lidhjeje me Fatos Nanon duket se zbeh sferen e marredhenieve me Ilir Meten. Ne do te shikojme shkurtimisht me poshte se ne ç'menyre ndikon kjo rrethane ne trajtimin qe gazeta i u ben ngjarjeve ne Irak dhe politikës nderkombetare lidhur me to. Se dyti, gazeta ne fjale eshte relativisht e hapur mire ndaj nje game te gjere pikepamjesh apo interpretimesh lidhur me politiken e brendeshme dhe te jashteme te vendit. Na duket se pozicioni disi delikat i botuesit te saj qe strategjikisht eshte i interesuar t'a mbaje mire me te gjithë krahet e politikës shqiptare, i ben relativisht me te hapura faqet e gazetes se tij. Por edhe ky faktor duhet marre me kujdes ne konsiderate sepse ne rastin e marredhenieve te stafit te gazetes me nje nga ish analistet e saj, Fatos Lubonjen, dolen ne pah disa probleme qe kane te bejne me politikën redaksionale te ndjekura. E verteta eshte se Fatos Lubonja u ankua se botuesi i gazetes dhe drejtuesit e saj nuk kishin pranuar t'i botonin nje shkrim ne te cilin ai kritikonte ashpër Fatos Nanon lidhur me politiken e tij ne perkrahje te politikës dhe te strategjise amerikane lidhur me Irakun.

Po t'i kthehemi ndikimit te qendrimit qe mban gazeta ndaj rivalitetit Fatos Nano – Ilir Meta mbi trajtimin e krizes irakiane, do te paraqisnim nje rast te spikatur ne te cilin shprehet ai rol autonom i medias per te prodhuar ngjarje politike dhe per t'i transmetuar ato drejt publikut. Ne numurin e 12 marsit 2003, gazeta *Shekulli* boton nje artikull, por qe ka edhe natyren e nje lajmi, te titulluar *Komandot ne Irak, perplasen Nano – Meta*. Gazeta e paraqet pozicionin e Ilir Metes disi me te matur dhe me te terhequr lidhur me mbeshtetjen e nderhyrjes ushtarake ne Irak se qendrimi i kryeministrit Fatos Nano. Natyrisht,

nuk eshte fjala se gazeta pohon se Ilir Meta eshte kunder perkrahjes se veprimit ushtarak amerikan. Por, gjithesesi, ne gojen e Ilir Metes vihen thenie sipas te cilave, dergimi i komandove shqiptare ne Irak duhet bere duke u konsultuar me ngushtesisht me partneret europiane. Lidhur me perplasjen Nano – Meta qe njoftohet qysh ne titull, ne brendesi te materialit nuk gjen asnje fakt te mireqene per t'a mbeshtetur kete hipoteze. Kjo hipoteze behet duke iu referuar nje lajmi te dhene nga nje gazete italiane, e cila e sheh kundershkrimin e heshtur te Metes, tek fakti se ai nuk merrte pjese ne mbledhjen e qeverise ku u mor vendimi per t'i propozuar Kuvendit krijimin e lehtesirave per koalicionin ushtarak kunder regjimit te Sadam Hyseinit.

Perse e boton gazeta kete artikull duke i vene nje titull provokues ? Mund te behen shume hamendje. Mund te thuhet per shembull se botuesi i gazetes i ben nje sherbim te radhes kryeministrit duke e nxjerre para publikut rivalin e tij ne parti dhe ne qeveri si jo fort proamerikan. Eshte ky nje lloj provokimi qe gazeta i ben Ilir Metes ? Mundet qe vertet Ilir Meta eshte me i permbajtur ne termat e shprehura per te deklaruar mbeshtetjen amerikane, por asnje fakt nuk eshte dhene per te vertetuar se qendrimi i tij real ndryshon nga ai i kryeministrit Fatos Nano. A mos valle eshte nje titull me nje kuptim shume me banal se ai qe desherojme t'i japim ? Mos valle nuk eshte vecse nje kurth qe i behet lexuesit me qellim qe ky i fundit te bleje gazeten me shpresen qe eshte perpara nje « skandali » dhe nje grindjeje te re ne gjirin e Partise socialiste ?

E verteta eshte se lidhur me pasqyrimin dhe percjelljen e politikës nderkombetare pergjate krizes irakiane, gazeta *Shekulli* ka qene ndofta gazeta me e hapur ndaj te gjitha pikepamjeve. Sigurisht qe ne te nuk do te gjejme qendrimet kunder nderhyrjes ushtarake ne Irak, por gjithesesi do te veme re se jane botuar jo pak artikuj qe tregojne ane kontradiktore te luftes, qe ngrejne probleme dhe veshtiresi qe ndeshin trupat aleate ne kete vend, qe flasin per rreziqet qe i u kanosen atyre, qe nuk fshehin interesat amerikane lidhur me naften irakiane dhe qe duhen marre sigurisht ne konsiderate kur behet fjale per nje analize te plote te politikës se jashteme amerikane. Eshte pikerisht ne kete gazete qe u botuan disa shifra, rezultate te nje sondazhi te opinionit publik, thene se ishte bere nga Gallup, e qe sipas gazetes tregonin se shumica e shqiptareve ishte kunder luftes ne Irak. Po ne kete gazete jane botuar edhe artikujt « me te forte » ne mbeshtetjen e nderhyrjes ushtarake amerikane ne Irak.

8. Gjuha e dyfishte e mediave dhe e politikës

Klasa politike shqiptare mbajti nje qendrim mediatik te hapur ne perkrahje te politikës amerikane, por gjithesesi, ne vetevete, ajo ka perjetuar dhe perjeton, faktin e te ndodhurit ne vorbullen e nje konflikti Shtete te Bashkuara te Amerikes – Europe qe e ben te ndjehet e shqetesuar. Siguria politike e ushtarake e Shqiperise mbeshtet me shume tek faktori amerikan, ndersa shpresa per nje zhvillim ekonomik dhe integrim shoqeror perendimor orientohet me shume drejt faktorit europian. Klasa politike shqiptare, ndofta per here te pare ne periudhen e tranzicionit postkomunist, perjetoi dramatikisht tensionin midis aktoreve te medhenj nderkombetare.

Ne keto raste, ajo nuk mungoi te levize midis nje gjuhe politike te qarte dhe nje gjuhe politike disi te perturbuar nga deshira per te mos e prishur hapur me asnje pale. Fatmiresisht per te çeshtja e luftes u zgjidh shpejt dhe tensioni nderkombetar, se paku ne pamje te pare, ra shpejt. Por, ne parim problemi mbetet dhe ai do te krijojte medoemos shqetesime te reja per klasen politike te vendit dhe per shoqerine shqiptare ne pergjithesi. Kemi te bejme me nje çeshtje per te cilen klasa politike shqiptare nuk eshte ende e pergatitur siç duhet.

Kjo gjuhe disi kontradiktore, as « mish as peshk », e perturbuar, u ndje ne disa raste dhe u perdor si nje lloj « gjuhe e dyte », e vene ne perdorim per te gene disi ne perputhje me presionet e faktorit europian. Ne te vertet, disa here, klasa politike shqiptare perdori dy lloj gjuhesh, njerin per te siguruar perfundimisht faktorin amerikan per mbeshtetjen e pales shqiptare dhe tjetren per te dialoguar, per aq sa do te ishte e mundur, me faktorin europian. Po te shohim me kujdes, gjuha e pare eshte ajo qe shpreh me vertetesi qendrimin shqiptar, ndersa gjuha e dyte me shume eshte nje gjuhe « ndjese », konformizmi, disi e genjeshtert, por qe nenkupton edhe nje lloj hezitimi, i cili nesiser mund te zhvillohet drejt qendrimeve me te prera.

Kete lloj gjuhe te dyte qe permban nje realitet politik te padukshem, ne e gjejme sidomos ne tekstin e deklarates se Kuvendit me rastin e deklarimit te lehtesirave per nderhyrjen ushtarake ne Irak, bere ne javen e pare te marsit 2003. Ne kete tekst zyrtar, nga me te çuditshmit dhe te perturbuarit, lekundjet e klases politike shqiptare shprehen ne menyre te konsiderueshme, ndonese disi te fshehura.

Teksti ne fjale te le te nenkuptosh qe ne fillim se klasa politike shqiptare ne inkoshiencen e saj eshte hezituese dhe po perpiqet te shohe se nga do te kaloje. Ne fjaline e pare te tekstit te deklarates thuhet se : « Kuvendi i Republikes se Shqiperise po ndjek me vemendje dhe me shqetesim te veçante zhvillimin e ngjarjeve te koheve te fundit ne Irak... ». Hezitimi vazhdon edhe me tej sepse pasi adoptohet teza amerikane se rregjimi i Sadamit denohet « per mosbashkepunim konform rezolutes se Kombeve te Bashkuara », menjehere pohohet teza europiane se Kuvendi shqiptar « mbeshtet perpjekjet e koalicionit nderkombetar per zgjidhjen e problemeve ne rruge diplomatike ». Gjuha behet vertet e nderlikuar ne vazhdim. Pasi thuhet se do te jepen te gjitha « lehtesirat per trupat » ushtarake qe do te mund te angazhohen ne Luftet (pra sipas variantit amerikan pergatitjet per luftet quhen te mireqena), shenohet se keto lehtesira do te jepen « ne rast te nje sulmi te koalicionit kunder rregjimit te Sadam Hyseinit. » Shprehja « ne rast » ne fakt perben nje lloj shkeputje nga vendosmeria amerikane qe as nuk e vinte ne dyshim fillimin e Luftes. Nderkohe qe flitet per « trupa ushtarake », nuk thuhet se te kujt do te jene ato trupa, behet fjale per nje « Aleance » qe do te veproje « ne rast te ndonje sulmi ». Pra, nuk specifikohet se ndaj ciles Aleance eshte i hapur territori shqiptar. Paradoksalisht, nese edhe Franca, Gjermania, Belgjika, apo aleate te tyre do te krijonin ndonje « aleance » te tyren per te nderhyre ushtarakisht ne Irak, si pale me vete, kjo deklarate nenkupton, e formuluar siç eshte, se edhe atyre do t'iu vihej ne sherbim territori shqiptar !

9. Disa perfundime

1. Shtypi shqiptar i ka percjelle relativisht ne menyre te gjere dhe korrekte jehonen e politikës nderkombetare dhe te ngjarjeve ne Irak. Ne niveli e lajmeve politike dhe ushtarake, gazetë shqiptare e kanë informuar shpejt dhe gjerësisht publikun rreth fakteve, ngjarjeve dhe problemeve te medha te Luftes.
2. Pavaresisht se ne planin e ideve nuk janë percjelle ne detaje teorite, pikepamjet, argumentat e dhena nga kundërshtuesit e nderhyrjes ushtarake ne Irak, megjithate ka vend te pohohet se lexuesi shqiptar ka patur mundësi te gjeje ne vija te pergjitheshme si argumentat pro luftes ne Irak ashtu edhe ato kunder nderhyrjes ushtarake angloamerikane ne kete vend. Mund te thuhet fare mire se ky qendrim perben nje fakt te mirepritur te nje lloj autonomie te shtypit ndaj politikës shqiptare. Eshte me vend te theksojme se ai mund te marre dhe domethenien e nje shprehjeje faktike te lirise shtypit ne vend.
3. Shtypi shqiptar ashtu sikurse politika shqiptare janë percaktuar me se shumti dhe ne menyre mbizotëruese nga nje dëshire per qene ne krah te politikës se jashtme amerikane dhe ne perkrahje te nderhyrjes ushtarake ne Irak. Mirepo, mund te pohohet gjithashtu se ne shtyp, drejtperdrejt apo terthorazi, janë shprehur edhe teza, pikepamje dhe janë botuar edhe analiza, te cilat nese nuk e kundërshtojne gjithnje radikalisht kete politike te ndjekur, perseri ngrajne probleme serioze lidhur me efikasitetin dhe dobine e saj.
4. Duke qene se Lufta ne Irak perfaqeson nje ngjarje qe ndodh megjithate disi larg Shqiperise dhe pak a shume jashte sferes se shtrirjes se interesave te saja kombetare, qendrimi ndaj nderhyrjes ne Irak, eshte perjetuar me shume si nje qendrim ndaj aktoreve kryesore politike nderkombetare, pra si nje qendrim ndaj nje Evrope te Bashkuar te perfaqesuar me shume nga blloku France-Gjermani-Belgjike (por edhe nga institucione te Bashkimit europian) dhe nga Shtetet e Bashkuara te Amerikes. Konflikti SHBA – Irak ne Shqiperi u perjetua se tepermi dhe me perparesi si nje konflikt SHBA – Evrope e Bashkuar.
5. Ne pergjithësi si argumentat ne perkrahje te Luftes ashtu dhe argumentat kunder saj, pavaresisht faktit se shpesh kanë qene te perpunuar me kujdes, gjithësesi, si çdo argument tjetër, asnjehere nuk kanë qene te plote, te vetemjaftueshem dhe teresisht bindes, çka do te bente, virtualisht, qe zgjedhja e bere nga politika shqiptare dhe mediat shqiptare te ishte e bazuar teresisht mbi nje baze pastertisht racionale. Largesia nga vendi i ngjarjes dhe nga problematika konkrete e Luftes e ka veshtiresuar ne fakt mbajtjen e nje cilesie gjithmone te larte te nivelit argumentues te politikës se ndjekur. Duke qene keshtu, mund te pohohet se zgjedhja e bere eshte ne radhe te pare nje vendim i bazuar ne interesa politike, ne gjeostrategji globale dhe ne perlllogaritje avantazhesh politike personale apo kolektive.
6. Radikalizimi i gjuhes se politikës shqiptare ne perkrahje te nderhyrjes ushtarake ne Irak eshte shprehje e faktit se forcat politike shqiptare kanë marredhenie teper konfliktuale me njera tjetern çka i ben qe te perforcjne gjuhen dhe tonin e deklaratave politike me qellim qe te rivalizojne kundërshtaret e tyre politike.

7. Ne qendrimet e mbajtura lidhur me perkrahjen e politikës së nderhyrjes ushtarake në Irak, klasa politike shqiptare, në fakt, riprodhon një traditë të fuqishme të saj që vjen prej kultures së saj politike tradicionale. Kjo traditë shprehet ndër të tjera në tre parime themelore të ndërtimit të politikave gjeostrategjike në rrafshin nderkombëtar : a. Parimi i parë ka të bëjë me rreshtimin pas me të fortit në planin e rivalitetëve të aktoreve politike nderkombëtare. b. Parimi i dytë ka të bëjë me një situatë me të komplikuar. Ai vihet në përdorim atëherë kur balanca e forcës së aktoreve të mëdhenj nderkombëtar që ndikojnë mbi jetën shqiptare është tepër e lekundur. Në këtë rast politika shqiptare ka mbajtur gjithmone një gjuhë hezituese, me dy kuptime. Këtë lloj gjuhe do t'ua quanim « perturbim dhe dyfishim të ligjerimit politik dhe mediatik » të komunikuar. Faza e gjuhes së dyfishtë kalon gjithmone relativisht shpejt dhe, në këtë rast, qendrimi i elites politike shqiptare ka qenë gjithmone në perkrahje të fuqisë me të fortë dhe me ndikuesë në politiken nderkombëtare dhe atë shqiptare duke e lënë për me pas zgjidhjen e një lloj konflikti me aktoret e tjera politike nderkombëtare. Në rastin konkret, politika shqiptare i dha përparesi afrimit të saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, afrimit të saj me strukturat e aleancës së Atlantikut të Veriut, duke e vënë përkoheishtë disi në plan të dytë strategjine e integritimit evropian. c. Politika shqiptare priret në përgjithësi të gjeje dhe të perkrahe atë aleatë të mëdhenj, të cilët parimisht nuk janë edhe aleatë të ngushtë me kombet fqinje, domethënë me sllavët e Jugut dhe me popullsitë ortodokse të Ballkanit.
8. Qendrimet kundër nderhyrjes ushtarake në Irak janë shprehur me tepër si zgjedhje të bera në planin personal të autoreve të tyre. Ndërsa qendrimet në perkrahje të politikës amerikane kanë marrë edhe formën e deklaratave politike që përfaqësojnë identitete politike dhe institucionale të mirefillta. Kjo lidhet ndër të tjera me faktin se shoqëria shqiptare i ka ende të pazhvilluara strukturat kolektive shoqërore, grupet e presionit politik, kohezionet shoqërore, profesionale e politike kolektive. Midis shtetit dhe klases politike që e udhëheq atë dhe individit të thjeshtë ekziston një ndarje e thellë, qëndron një boshllëk i krijuar nga mungesa e kulturave shoqërore kolektive. Në përgjithësi shtypi riprodhon qendrimet e politikës duke ia përcjelle ato qytetarit. Shtypi dhe mediat ndihen pak nën presionin e aktoreve politike kolektive. Kjo mund të shpjegojë edhe faktin se përse, ndoshta lumturisht, disa grupe shoqërore shqiptare, me identitet kulturor virtualisht të ngjashëm me atë të disa faktorëve shoqërore nderkombëtarë që i rrezistuan nderhyrjes ushtarake në Irak, nuk u shprehën hapur dhe qartë kundër rreshtimit politik të qeverisë shqiptare. Nga kjo pikepamje, klasa politike dhe mediatike shqiptare i ka pasur « duart » relativisht të lira. Vete ajo funksion me tepër si një agregat që ndjek me tepër disa qëllime pragmatike sesa vepron si një strukturë kolektive që i bindet edhe paradigmave të veta kulturore apo imperativave të saj morale.

Pa ndare aspak të njejtin qendrim me Fatos T. Lubonjen lidhur me kuptimin dhe pasojat e nderhyrjes ushtarake angloamerikane në Irak, konsiderojmë megjithatë se analiza e tij mbi strukturën kulturore dhe nenkulturat politike të shoqërisë shqiptare të tranzicionit ka elemente shumë të gjetur. Ai e karakterizon këtë realitet si me poshtë : « Ekziston një solidaritet që do t'ua quaja të injorancës e të paragjykimit ose të mungesës së personalitetit e në

fakt edhe te mungeses se pluralizmit te vertete. Ky lloj solidariteti i injorances ben qe Shqiperia te jete vendi ku per çeshtje nga ato qe jane teper te rendesishme ne boten e qyteteruar, siç eshte edhe kjo e luftes kunder Irakut, nuk ka te majte dhe te djathte dhe liberale, ku nuk ka nacionaliste dhe internacionaliste, ku nuk ka fetare dhe ateiste, nuk ka myslimane dhe te krishtere ne kuptimin e zhvillimit te nje dialogu midis tyre. »